


50

THE
MAGAZINE
OF THE
MOUNTAIN



50

LOJËRA DHE USHTRIME PËR TRAJNERË



Save the Children

Programi për Shqipërinë

Ky botim është shkëputur nga "Participatory Methodology Series" e International Institute for Environment and Development, UK.

50 lojëra dhe ushtrime për trajnerë

Ky libër u përkthye dhe botohet në shqip nga Save the Children in Albania, me miratimin e International Institute for Environment and Development, UK.

Botimi i këtij libri u mundësua nga fonde të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, Agjencisë së Ndihmës Ndërkombëtare të Suedisë (SIDA) dhe Fondacionit Oak, në kuadrin e Programit Rajonal Kundër Trafikimit të Fëmijëve.

Përkthimi dhe redaktimi letrar në gjuhën shqipe nga **Zana Lita** dhe **Anduena Shkurti**

Faqosja: Studio SIENA

Shtypur në shtypshkronjën “Mirgeeralb”

Tiranë, 2006

Tirazhi 1000 kopje



50 LOJËRA DHE USHTRIME PËR TRAJNERË

USHTRIME PËR HYRJE DHETHYERJA E AKULLIT	5
1. INTERVISTAT NË ÇIFTE	5
2. AJO ÇFARË PRITET DHE RREGULLAT ME SHKRIM	7
3. PREZANTIMI I EMRIT	8
4. SHPRESA DHE FRIKA	9
5. AUTOPORTRETET	11
6. DIÇKA NGA SHTËPIA	12
7. NGJARJET E RËNDËSISHME	13
8. PREZANTIMET SIMBOLIKE	14
9. VIZATIMI I KONCEPTEVE	15
10. PËRZJERËSI I FARËS	16
11. LOJA ME EMRIN	17
12. CILËT JANË ATA?	18
USHTRIME PËR GJALLËRIMIN DHE FORMIMIN E GRUPIT	19
13. SALLATA E FRUTAVE	19
14. "A-TË" DHE "B-TË"	21
15. LOJA ME NUMRAT	23
16. LËVIZ NGA VENDI	23
17. LËVIZ NËSE	24
18. RRUGËT DHE BULEVARDET	25
19. ANËTARËT E FAMILJES	26
20. DEPËRTIMI	27
21. NDAL STATUJËS	28
22. NUMRIMI I ANASJELLTË	29
23. USHTRIM PËR VETËZGJEDHJEN E GRUPIT	30
24. SKULPTURA NË GRUP	31
USHTRIME PËR PËRFORCIMIN E DINAMIKËS NË GRUP	32
25. TEKNIKA E GRUPIT NOMINAL	32
26. PROFILET E GRUPEVE	34
27. SABOTATORI	36

28. PROBLEM LËMSH	38
29. ECJA ME BESIM	39
30. USHTRIMI ZGJIDHJA E PROBLEMIT NË GRUP DHE KONTRATA NË GRUP	40
31. KARRIKET	42
32. STRATEGJITË NË GRUP - DILEMA E TË BURGOSURIT	44
33. KATRRORËT BASHKËPUNUES	46
34. ENIGMA ME KARTOLINA OSE ME COPËZA FIGURASH	48
35. SHIH SE KUSH PO FLET	50
36. KATRORI PREJ LITARI	51
37. QOSHJA IME	52
38. ROLET NË GRUP	53
38. ROLET NË GRUP	54
39. PËRJASHTIMI I NUMRAVE	55
USHTRIME PËR PËRMIRËSIMIN ETË DËGJUARIT DHEVËZHGININ	56
40. SHKREPËSET	56
41. LOJA E JASTËKUT	57
42. SHIKOJE	58
43. RRATHËT PA FJALË	59
44. DEBATI I VOTIMIT	60
45. LOJA ME PALOSJEN E LETRËS	62
46. VIZATIMI I TULLAVE	63
47. TË DËGJUARIT ME EMPATI	65
48. MIRATUESIT DHE KUNDËRSHTUESIT ME ANË TË TUNDJES SË KOKËS	66
49. TELEFONI I PRISHUR DHE COPËZA TË NGJARJES	67
50. K APO H?	69



- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të zbulojë se çfarë duan të mësojnë pjesëmarrësit nga kjo seancë, ky uorkshop apo kurs trajnimi, si dhe të mësojnë pak rreth tipave të njerëzve.
 - Të ndihmojë për vlerësimin e kursit në fund të trajnimit.
 - T'i çlirojë pjesëmarrësit nga stresi në fillim të kursit të trajnimit.

👁️ **MJETET:** Letër, lapsa.

🕒 **KOHA:** 20 – 45 minuta (në varësi të numrit të pjesëmarrësve).

- 📝 **ECURIA:**
1. Ndaji pjesëmarrësit në çifte. Kërko që çdo pjesëmarrës të intervistojë partnerin e tij, duke u përqendruar në pyetje të tilla, si:
 - *Si ju quajnë? Përse keni studiuar dhe ç'përvojë keni?*
 - *Përse e ndiqni këtë kurs? Çfarë shpresoni të mësoni prej tij?*
 - *A keni përvoja të mëparshme në metodat e pjesëmarrjes në këtë fushë?*
 - *Emërtoni dy gjëra të mira që ju kanë ndodhur në vitet e kaluara.*
 2. Pas pesë minutash që pjesëmarrësit kanë intervistuar njëri-tjetrin, ata raportojnë në seancën dëgjimore lidhur me partnerin e tyre, duke dhënë në mënyrë të përmbledhur informacionin kryesor në një minutë.

“ **KOMENTET:** Kyçi i ushtrimit është që pjesëmarrësit të mos raportojnë për veten. Në këtë mënyrë ata nuk ndjehen të sikletosur, ndërkohë që presin t'u vijë radha. Përveç kësaj, ushtrimi nuk synon që vetëm njëri të intervistojë tjetrin. Ti, si trajnues, mund ta kuptosh vetëm më vonë që një punonjës i rangut të ulët ka intervistuar një drejtor apo anasjelltas. Nëse janë diskutuar më parë ato çfarë presin pjesëmarrësit, trajnuesi mund t'i shkruajë në tabakë letre, të cilat mund të ngjiten më vonë në mur, gjatë uorkshopit. Më pas, pjesëmarrësit mund të përdorin listën për të monitoruar nëse janë plotësuar ato çfarë prisnin ata ose nëse ato kanë ndryshuar.

Pra një përvojë e mirë për ty këtë vit ishte zgjedhja si anëtare e qeverisë studentore. Çfarë mund të më thuash tjetër?

Me një grup të madh (mbi 20 persona), problemi kryesor qëndron në kufizimin e kohës për secilën përgjigje. Nëse secilit person i duhen 2 ose 3 minuta për të raportuar, shumë nga pjesëmarrësit do të mërziten, ndërkohë që ti po përdor një pjesë të çmuar të kohës. Nëse ua shpjegon këtë


(vazhdon në faqen tjetër)


1. INTERVISTAT NË ÇIFTE (vazhdim)


“ KOMENTET: pjesëmarrësve, atëherë ata do të bëjnë më shumë kujdes për t’ju përmbajtur minutazhit që kanë në dispozicion. Atyre mund t’u kërkosh që raportimin ta kufizojnë vetëm me emrin, përvojën dhe dy gjëra të mira që u kanë ndodhur vitin e kaluar. Nëse e di apo dyshon që shumë nga pjesëmarrësit janë dërguar në trajnim pa dëshirën e tyre, nuk dinë gjë për të e, për pasojë, nuk mund të jenë të qartë së ç’presin nga ky trajnim, atëherë t’i pyesësh se çfarë presin ata nga ky trajnim, do të ishte krejtësisht e pavend dhe e vështirë. Në vend të kësaj, përqendrohu në pyetje të tjera, si, p.sh., dy gjëra të mira që u kanë ndodhur.


Mund të të duket me vend që ky ushtrim të jetë i dobishëm edhe për vlerësimet. Për ta përdorur atë me këtë qëllim, ndrysho pyetjet që i bëjnë çiftet njëri - tjetrit dhe konkretisht:

- *Deri në ç’masë plotësoi kursi ato çfarë prisje prej tij?*
- *Çfarë t’u duk më e dobishme?*
- *Çfarë t’u duk më pak e dobishme?*
- *Çfarë do të ndryshoje në këtë kurs, nëse do të bëhej edhe njëherë?*


 **OBJEKTIVAT:** ■ Të trajtojë me hollësi atë që duan apo nuk duan pjesëmarrësit nga seanca e trajnimit apo uorkshopi.

 **MJETET:** Rreth pesë copa letrash (me madhësi 4 x 6 cm) për çdo pjesëmarrës, lapsa, tabakë letre, ngjitëse (natriban) ose adeziv.

 **KOHA:** 15 - 45 minuta.

 **ECURIA:**

1. Përgatit tabakë letre ku të jenë shkruar fjalët: përmbajtja, formati (konceptimin e tij), hollësitë praktike.
2. Kërkoji pjesëmarrësve që në secilën prej tabakëve të vogla të letrës, të shkruajnë një gjë që e duan ose që nuk e duan nga seanca e trajnimit. Kjo mund të lidhet me përmbajtjen, formatin apo me hollësitë praktike (ndalohet duhani, secili të ndihmojë në gatim etj.).
3. Pastaj pjesëmarrësit i ngjisin fletushkat e tyre në tabakun përkatës, duke i grupuar të gjitha fletushkat sipas një çështjeje ose ideje specifike. Për shembull, të gjitha fletushkat që lidhen me përgatitjen e ushqimit të jenë në një vend në tabakun ku është shkruar "Hollësitë praktike". Në një grup të madh do të rekomandohej që tabakët të copëzoheshin edhe më shumë - ndoshta në tabakë ku të shkruhet "Formati i diskutimit", "Formati i vendimit" etj.
4. Kur janë grumbulluar të gjitha mendimet e pjesëmarrësve lidhur me atë se çfarë presin ata nga trajnimi dhe pasi të jenë grupuar në këtë mënyrë, ato mund të diskutohen dhe mund të arrihet në një mendim unanim, nëse është e nevojshme, lidhur me rregullat bazë të mirëkuptuara nga të gjithë. Kjo të krijon mundësinë që t'i plotësosh kërkesat e tyre ndaj trajnimit, të cilat kanë ose nuk kanë gjasë që të plotësohen.

 **KOMENTET:** Kjo të jep mundësinë që të shënosh çfarë duan apo nuk duan njerëzit nga trajnimi. Në të njëjtën kohë, të lehtëson që të përcaktosh se në ç'masë pjesëmarrësit kanë të njëjtën mendje që në fillim të uorkshopit, si dhe për të punuar që të arrihet një nivel më i lartë i marrëveshjes me ta. Gjithashtu, është e dobishme t'u kthehesh këtyre tabakëve, gjatë vlerësimit në fund të seancës, për të parë me saktësi se deri në ç'masë janë plotësuar ose jo pikat për të cilat shpresojnë pjesëmarrësit. Një mundësi është që çdo pjesëmarrësi t'i jepet një numër i vogël letrash ngjitëse (p.sh. tre), që t'i ngjisin pranë çështjeve për të cilat shpresojnë dhe që janë realizuar gjatë seminarit.

Një mënyrë më pak e strukturuar për të marrë komente me shkrim për çfarë shpresojnë, do të ishte përdorimi i një table të zezë, ku të shkruhen vërejtjet (Ushtrimi 66). Për këtë, mund të përgatisni dy tabakë letre, ku të shkruhet: "Çfarë shpresojnë pjesëmarrësit dhe nga se kanë frikë ata?".

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Për të filluar seminarin me një çështje informale.
 - Për të prezantuar secilin nga pjesëmarrësit.

👁️ **MJETET:** Nuk nevojiten.

🕒 **KOHA:** 5 minuta.

✍️ **ECURIA:**

1. Çdo pjesëmarrësi, me radhë, i kërkohet të prezantojë thjesht veten, duke shtuar një mbiemër para emrit të tij, që fillon me të njëjtën shkronjë si të emrit. Për shembull:

Unë jam Sonja serioze.

Unë jam Bardha bufe.

Unë jam Meri mbërdhace.


Unë jam Frida frikacake.

2. Kjo mund të bëhet ndërkohë që pjesëmarrësit janë të ulur, por krijon më shumë kënaqësi dhe gjallëri nëse pjesëmarrësit qëndrojnë në formë rrethi. Thuaji secilit person që ta shoqërojë emrin e vet me një lëvizje ose gjest (p.sh., vetulla të ngrysur, faqe të fryra, shpatulla të mbledhura, fytyrë të mbuluar me duar), duke shkelur jashtë rrethit. Kur personi shkel jashtë rrethit, do të thotë që radhën e ka personi tjetër.

“ **KOMENTET:** Nuk është nevoja që pas këtij ushtrimi të bëhet ndonjë analizë. Ky ushtrim mund të shërbejë si një pikë referimi për pjesën tjetër të trajnimit ose kursit, pasi pjesëmarrësit do të mbajnë mend mbiemrat që shkaktuan humor. Akoma më i rëndësishëm është mjedisi miqësor që krijohet. Lëvizja fizike i çlodh pjesëmarrësit dhe i bën që të ndjehen mirë me të tjerët.




4. SHPRESA DHE FRIKA


 **OBJEKTIVAT:** ■ T'i lejojë pjesëmarrësit të shprehen, ndajnë dhe pakësojnë konceptimet e gabuara që mund të kenë pasur para se të vijnë në trajnim.

 **MJETET:** Tabakë letre ose letër A4.

 **KOHA:** 25 minuta.

 **ECURIA:** Në disa uorkshope pjesëmarrësit mund të vinë nga zona të largëta dhe mund të dinë shumë pak për programin e propozuar. Mund të mos njohin njëri - tjetrin ose mund të mos dinë se ç'kërkohej prej tyre. Në raste të tilla, do të ishte me vend që të krijohet një forum, ku pjesëmarrësit të diskutojnë dhe shkëmbejnë mendime rreth disa koncepteve të gabuara.

1. Ndaji pjesëmarrësit në grupe të vogla prej 4-6 personash. Jepi secilit grup një tabak letre ose letra A 4.
2. Kërko që secili grup të përzgjedhë dikë që të shënojë informacionin. Kërkoju që t'u përgjigjen shpejt pyetjes: "Çfarë frike, shqetësimesh apo nocione të konceptuara paraprakisht kishit para se të vinit në trajnim sot?"
3. Pasi ke mbledhur shpejt përgjigjet, kërko nga raportuesit t'ia paraqesin listën e tyre të gjithë grupit. Kjo krijon mundësi të shkëlqyera për trajnuesin, që të njihet dhe të marrë parasysh nevojat e personave që trajnohen. Gjithashtu, kjo shërben që pikat të përdoren për të treguar nëse seminari përputhet ose jo me interesat që kanë ata.

 **KOMENTET:** Kur të bëhet analiza, përdor pyetjet e mëposhtme për të të ardhur në ndihmë:

1. *Cilat ishin disa prej çështjeve për të cilat kishit frikë që ju shqetësonin apo disa nga nocionet që kishit menduar paraprakisht për secilin grup?*
 - A do të jem unë personi më i madh në moshë?
 - A do të jem unë i vetmi burrë?
 - A do të veproj si duhet në seminarin tim të pare profesional?
 - Jam i sigurt që secili do të jetë më me shumë përvojë sesa unë.
 - Çfarë do të përfitoj nga ky program trajnimi?

(vazhdon në faqen tjetër)

4. SHPRESA DHE FRIKA (vazhdim)

“ KOMENTET:

- Çfarë pyetje duhet të bëj?
- Si do të jetë dhoma ku zhvillohet seminari, programi, trajnuesit?
- A do të marrim dietat e premtuara?



2. Çfarë mund të bëj unë apo trajnerët për t'i zvogëluar këto shqetësime? Mundësitë përfshijnë shpjegimin e shkurtimeve të fjalëve, përgatitjen e kopjeve të fletëve transparente që do të përdoren, të folurit ngadalë etj.

5. AUTOPORTRETET

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të krijojë një mjedis ku njerëzit të ndien lirshëm dhe të lejojë që secili pjesëmarrës të paraqesë aspektet e tij.
 - Të thyejë akullin në një grup që tashmë e njohin njëri - tjetrin.

👁️ **MJETET:** Një tabak letre dhe një stilolaps për secilin pjesëmarrës.

🕒 **KOHA:** 10 minuta për vizatimin e portretit dhe 10 minuta për të parë miniekspozitën me autoportrete.

- ✍️ **ECURIA:**
1. Kërkoju pjesëmarrësve të vizatojnë autoportretin në një fletë. Ata mund të përzgjedhin stilin që u pëlqen – artistik, karikaturë, abstraksion. Kërkoju që të shkruajnë emrin e tyre në autoportret.
 2. Kërkoju që të shkruajnë në fund të fletës ngjarjet më të rëndësishme që i kanë shtyrë për të marrë pjesë në këtë uorkshop. (Shih Ushtrimin 7 për hollësi të mëtejshme.)
 3. Grumbulloji autoportretet dhe ekspozoi ato në tabelë ose në mur.
 4. Jepu pjesëmarrësve mundësinë që të shikojnë ekspozitën.

“ **KOMENTET:** Ky ushtrim zakonisht i argëton pjesëmarrësit. Ai është një mjet i mirë për të zbehur dallimet midis tyre dhe një akullthyes i përshtatshëm. Është teknikë e mirë për të mësuar emra të rinj dhe për të kujtuar emrat e vjetër, pasi pjesëmarrësit fillojnë ta lidhin diçka vizuale me ngjarjet më të rëndësishme dhe emrat. Nëse ata që janë në grup e njohin njëri - tjetrin (p. sh., nëse ata janë nga i njëjti institucion), një variant është që t'u thuhet pjesëmarrësve të mos shkruajnë emrat e tyre përbri/poshtë autoportreteve. Pastaj, kur ata shohin portretet në miniekspozitë, do t'u duhet të gjejnë personin që fshihet pas tij. Ky mund të bëhet një konkurs formal, ku secili person shkruan emrin e personit që hamendëson në një copë letre, të cilat, më pas, mblidhen dhe vlerësohen me pikë nga lehtësuesi i trajnimit.

6. DIÇKA NGA SHTËPIA

✓ **OBJEKTIVAT:** ▪ Të shpejtojë procesin e njohjes.

👁️ **MJETET:** Nuk nevojiten.


🕒 **KOHA:** Në varësi të madhësisë së grupit.

- ✍️ **ECURIA:**
1. Trajnuesi shpjegon qëllimin e ushtrimit dhe e paraqet atë, duke thënë diçka të tillë: *“Mundohuni të përqendrohni për një çast në shtëpinë tuaj. Mund të jetë më lehtë nëse mbyllni sytë. Pastaj zgjidhni një send, qoftë ky një objekt ose mobilje, ose diçka që është e prekshme (pamje, aromë, shije, ndjenjë) që për ju përfaqëson shtëpinë. Mendoni për të dhe përgatituni që t’ia përshkruani atë grupit.”*
 2. Anëtarët e grupit përshkruajnë artikullin që kanë zgjedhur. Si trajnues, ti mund të ndërhysh për t’i ndihmuar ata të shprehen qartë dhe të merren me pyetjet e të tjerëve.


💬 **KOMENTET:** Ky është një ushtrim që nuk i bën ata të ndjehen keq dhe krijon një atmosferë të këndshme. Është i përshtatshëm sidomos për pjesëmarrësit që sapo kanë ardhur nga një udhëtim i gjatë dhe që ende nuk janë ambientuar me mjedisin e ri. Ai duhet të pasohet nga ushtrime që tërheqin vëmendjen e tyre ndaj situatës aktuale.


Kjo mund të hajë kohë për një grup të madh, nëse secilit pjesëmarrës do t’i jepet një kohë e arsyeshme për ta përshkruar atë artikull.


7. NGJARJET E RËNDËSISHME

-  **OBJEKTIVAT:**
- Të fusë prezantimet sipas këndvështrimit historik.
 - Të mësojë nga vinë pjesëmarrës të ndryshëm dhe të dëgjojë.

 **MJETET:** Nuk nevojiten.

 **KOHA:** Në varësi të madhësisë së grupit.

-  **ECURIA:**
1. Kërko nga pjesëmarrësit që të punojnë në çifte. Secili duhet të zgjedhë 3-4 ngjarje të rëndësishme të jetës së vet, të cilat janë të rëndësishme për t'i sjellë në uorkshop.
 - *Përvojë nga fëmijëria.*
 - *Ndikimi i prindërve, kushërinjve, shokëve.*
 - *Përvoja të trajnimit formal.*
 - *Ngjarje kyçe, mbledhje, lexime librash, realizime.*
 - *Ndryshime në karrierë, përvojë pune.*
 - *Ose çfarëdo ngjarjesh të rëndësishme.*
 2. Fillo duke dhënë një shembull të një ngjarjeje të rëndësishme të jetës tënde. Duke përmendur diçka për të qeshur ose që nuk lidhet me temën, mund të tregosh që kjo punë nuk është serioze.
 3. Pjesëmarrësit mund t'ia thonë ngjarjen e tyre të rëndësishme grupit. Kjo mund të bëhet në disa mënyra: drejtpërsëdrejti me grupin, nga prezantimet në çift ose në mënyrë vizive, duke ekspozuar ngjarjet e rëndësishme që t'i shohë i gjithë grupi.

 **KOMENTET:** Ky ushtrim mund të zërë ca kohë, veçanërisht nëse grupi është i madh (20 ose më shumë veta). Mund t'ju dalë nevoja për t'i kujtuar njerëzit që t'u përmbahen ngjarjeve të rëndësishme dhe të mos u kushtojnë vëmendje hollësive.

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të njohë pjesëmarrësit me njëri – tjetrin.
 - Të bëjë që pjesëmarrësit të flasin me njëri- tjetrin në grupe të vogla.
 - Të motivojë grupet e vogla, duke i përfshirë ata në një detyrë të suksesshme.
 - Të bëjë që ata ta ndejnë që i përkasin një grupimi të caktuar.
 - Të tregosh se edhe ti, si trajnues, dëshiron të mësosh prej tyre.

👁️ **MJETET:** Objektet përreth, brenda ose afër sallës ku zhvillohet uorkshopi, që mund të përdoren si simbole, për të cilat nuk nevojitet përgatitje.

🕒 **KOHA:** 20 -30 minuta në varësi të madhësisë së grupit (3 minuta prezantim midis vetë pjesëmarrësve, 10 minuta për të vendosur dhe gjetur objektet, 3 minuta për hyrjen në seancën dëgjimore dhe sqarime nga secili grup).


- 📖 **ECURIA:**
1. Kërko nga pjesëmarrësit që të formojnë grupe me tre persona dhe të gjejnë një objekt, ndoshta jashtë, për të cilin ata mendojnë se simbolizon vendin, rajonin, organizatën e tyre.
 2. Kërkoju atyre që ta sjellin objektin përsëri dhe ta vendosin në tryezë.
 3. Kërko që pjesëmarrësit të prezantojnë veten dhe të shpjegojnë përse zgjedhën këtë objekt si simbolin e tyre.

“ **KOMENTET:** Ky ushtrim është i dobishëm për t'i inkurajuar pjesëmarrësit që të jenë më të hapur dhe të ndajnë ndjenjat e tyre që në fillimin e uorkshomit.





Prezantimet bëhen edhe ndërkohë që kërkohet apo bihet dakord për simbolin. Këto grupe të emëtuara sipas simbolit që kanë zgjedhur, mund të përdoren për ushtrimet e mëvonshme, të cilat do të kërkojnë ndarjen në grupe më të vogla. Nëse nuk keni njohuri për rajonin ose vendin, simbolet janë një prezantim i mirë i sistemit të vlerave lokale. Disa objekte, p. sh., mund të ishin një pirg me rërë, një kaktus, një pishë e zonës dhe një shall i endur nga një zonë e caktuar.


9. VIZATIMI I KONCEPTEVE

-  **OBJEKTIVAT:**
- Të prezantojë pjesëmarrësit me njëri - tjetrin dhe t'i bëjë ata të flasin.
 - Të motivojë grupet e vogla, duke i angazhuar ata menjëherë në detyra të thjeshta.
 - Të arrijë që të gjithë t'i kuptojnë njëloj konceptet kyçe.

 **MJETET:** Stilolaps dhe letër.

 **KOHA:** 1 deri në 1 orë e gjysmë.






-  **ECURIA:**
1. Ndaji grupet në grupe më të vogla me 4-7 pjesëmarrës (duke përdorur njërin nga ushtrimet për formimin e grupeve).
 2. Kërko nga secili grup që të bëjë një pikturë për një koncept kyç të caktuar. Ky koncept duhet të jetë njëloj për të gjitha grupet dhe mund të jetë në varësi të asaj se çfarë do të nxjerrësh në pah. Duhet të përzgjedhësh diçka për të cilën secili ka një mendim të vetin, si, p.sh., për pjesëmarrjen, zhvillimin që i qëndron kohës, shtrirjen, komunikimin.
 3. Grupeve të vogla u jepen 30 minuta për të diskutuar e vizatuar dhe, pas kësaj, një zëdhënës i grupit paraqet diagramën e përgatitur nga grupi. Një mënyrë tjetër është vendosja e diagramave në një miniekspozitë dhe inkurajimi i gjithësecilit për t'i hedhur një sy para se të bëhet diskutimi.

 **KOMENTET:** Pjesëmarrësve mund t'u bësh pyetjet e mëposhtme:


- *Cilat elemente ishin të përbashkëta për të gjitha grupet?*
- *Cilat elemente u përfaqësuan vetëm nga një grup?*
- *Si i shpjegoni këto ndryshime dhe ngjashmëri?*
- *Cilat janë disa nga boshtet disiplinore në diagramë?*
- *Si mendon ti që mund ta përfaqësonte një fshatar të njëjtin koncept dhe cilat do të ishin disa nga supozimet që do të bëje ti për të?*


Ki parasysh që diskutimi nuk duhet të përfundojë me një përkufizim të saktë, të vetëm. Përdori këto përkufizime për të theksuar se si gjithmonë ka këndvështrime të tjera për çështjet.

10. PËRZJERËSI I FARËS


-  **OBJEKTIVAT:**
- Të prezantojë pjesëmarrësit me njëri - tjetrin.
 - Të mundësojë që pjesëmarrësit të flasin me njëri – tjetrin.
 - Të krijojë një atmosferë çlodhëse e të gjallë, dhe t'i japë trajnimit një ton jozyrtar.
-  **MJETET:** Fara të mjaftueshme, guriçka ose zare për secilin pjesëmarrës sipas numrit të tyre (p. sh., në qoftë se ka 25 persona, duke përfshirë edhe trajnuesin, çdo person duhet të ketë 25 fara/kokrra fasulesh). Disa filxhanë kauçuku ose qese për pjesëmarrësit që nuk kanë xhepa.
-  **KOHA:** 10-25 minuta, në varësi të numrit të pjesëmarrësve dhe sasisë së kohës që flasin me njëri – tjetrin.
-  **ECURIA:**
1. Jepi secilit person një kokërr fasule (p. sh., në qoftë se janë 25 persona, përfshirë edhe trajnuesin, i cili do të marrë edhe ai pjesë në këtë ushtrim, jepi secilit 25 kokrra fasule).
 2. Kërko që t'i vendosin fasulet në njërin xhep dhe lëre xhepin e dytë bosh. Nëse ndonjëri nuk ka xhepa, në vend të tyre mund të përdorin dy filxhanë të vegjël ose qese.
 3. Pjesëmarrësve u jepet një kohë e caktuar në dispozicion (rreth 20 minuta), gjatë së cilës prezantohen me pjesëmarrësit e tjerë (ky prezantim mund të përfshijë emrin, institucionin ose projektin për të cilin punojnë, si dhe disa fjalë për veten e tyre).
 4. Gjatë secilit prezantim, ata duhet të japin një kokërr fasule dhe të pranojnë kokrra fasulesh prej tyre. Ata duhet t'i vendosin kokrrat e fasuleve të marra nga të tjerët në xhepin bosh ose në filxhan.
 5. Në fund të këtij ushtrimi, çdo personi duhet t'i mbetet një kokërr fasuleje në xhepin e parë (që përfaqëson veten), ndërsa xhepi i dytë duhet të jetë i mbushur me aq kokrra, sa numri total i personave që janë në dhomë, minus një.
-  **KOMENTET:** Ky ushtrim është i përshtatshëm për një numër pjesëmarrësish nga 10 deri në 50 veta, por nëse numri i tyre është më i madh sesa 30, është e këshillueshme që njerëzve t'u thuhet të flasin shkurt, ndryshe ushtrimi merr shumë kohë. Trajnuesit duhet të marrin pjesë në ushtrim.
- Është mirë që kur të keni mbërritur në dy të tretat e ushtrimit, t'i paralajmërosh pjesëmarrësit që koha po ikën. Nuk është e nevojshme të bëhet përmbledhje në fund të ushtrimit. Është një mënyrë shumë efektive që çdo person të ndeshet ballë për ballë, pa ceremony, me pjesëmarrësit e tjerë në trajnim. Gjithashtu, ky ushtrim krijon një atmosferë gazmore, ku të gjithë ndjehen mirë.


11. LOJA ME EMRIN

-  **OBJEKTIVAT:**
- Të përshpejtojë procesin e prezantimit.
 - T'i ndihmojë pjesëmarrësit që të mësojnë emrat e pjesëmarrësve të tjerë.

-  **MJETET:**
- Nuk nevojiten mjete, por vetëm karrike të vendosura në formë rrethi, mundësisht pa tryeza në mes.

-  **KOHA:**
- Në varësi të madhësisë së grupeve.

-  **ECURIA:**
1. Paraqit e shpjego ushtrimin, dhe secili nga pjesëmarrësit në formë rrethi të thotë emrin (pa mbiemër). Kjo bëhet ngadalë, me qëllim që edhe të tjerët të kenë kohë ta përsërisin emrin dhe të gjejnë një mënyrë për ta lidhur atë emër me personin e duhur. Emrat jo të zakonshëm mund të shkruhen në dërrasë. Një mënyrë tjetër është që secili pjesëmarrës mund të pyetet të japë ndihmën e vet, për t'i kujtuar kur të prezantojnë veten. Për shembull: “*Mua më quajnë Frank dhe unë gjithmonë përpiqem të jem!*”.
 2. Kur të përfundojë raundi, atëherë trajnuesi duhet të thotë: “*Mua më quajnë (.....)*”, drejton gishtin te një person tjetër (B), thotë emrin e B-së dhe i kërkon atij të shikojë personin C. Për shembull: “*Emri im është Frank, emri yt është Bert. Bert, a mund ta gjesh Klarën?*”. Duhet të shmangësh vështrimin te Klara, ndërkohë që bën këtë pyetje, dhe duhet t'i drejtohesh të gjithë grupit, jo Klarës, me qëllim që Berti të mos e kuptojë.
 3. Berti duhet të thotë emrin e vet, të tregojë me gisht Klarën, të përmendë emrin e saj dhe t'i kërkojë Klarës që të shikojë te personi D; në këtë çast Berti nuk duhet të shikojë në drejtimin e personit D.
 4. Vazhdo kështu derisa të gjithëve t'ju vijë radha.

-  **KOMENTET:**
- Ky është një ushtrim i thjeshtë, por shumë efektiv dhe shumë i pranueshëm nga grupet e reja. Mund të përdoret si ushtrim i parë kur fillon punën në grup. Njohja dhe shqiptimi i emrave është shumë i rëndësishëm në grupet e përzjera, ku mjaft prej emrave mund të mos jenë të njohur, mund të jenë kompleksë dhe mund të shqiptohen gabim.

Një variant tjetër është që kur secilit pjesëmarrës t'i ketë ardhur radha, kërkoj të ndryshojë vendin ku është ulur, me qëllim që të mos lidhen emrat me pozicionin që zë secili në rreth. Përdore këtë mënyrë edhe njëherë, derisa të bindesh që të tërë i dinë të gjithë emrat.

Në fund, pyeti pjesëmarrësit të thonë të gjithë emrat e pjesëtarëve të grupit sipas radhës që janë ulur. Ata që ngecin, mund të pyesin për emrat që nuk mbajnë mend.

12. CILËT JANË ATA?

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të prezantojë pjesëmarrësit me njëri - tjetrin në një situatë leksioni ose kur ka shumë pjesëmarrës (p.sh., 30-100).
 - Të përfshijë pjesëmarrësit në një veprimtari që kërkon lëvizjen e tyre në fillim të leksionit.

👁️ **MJETET:** Nuk nevojiten.

🕒 **KOHA:** 5 minuta.

- ✍️ **ECURIA:**
1. Kërko që pjesëmarrësit të ngrenë duart, kur u përgjigjen pyetjeve për të na thënë "cilët jemi ne?". Pyet se cili punon për institucionet qeveritare; cili është agronom, antropolog ose specialist për blegtorinë; cili ka përvojë në metodat pjesëmarrëse në këtë fushë; cili është nga ky qytet, nga ndonjë qytet tjetër etj.
 2. Pyeti pjesëmarrësit të shikojnë se me kë duan të bisedojnë më vonë.
 3. Pastaj pyet: "Ka ndonjë që është pa u pyetur apo pa folur?"

“ **KOMENTET:** Prezantimet një për një zakonisht hanë shumë kohë në grupe të mëdha, vetëm në qoftë se secili thotë vetëm emrin dhe organizatën ku punon. Por edhe pas kësaj, shumë pak njerëz mbajnë mend hollësi. Ky ushtrim i aktivizon të gjithë që në fillim dhe shumicës së njerëzve iu duket interesante që të dinë se cilët janë personat e ndryshëm në këtë grup. Zakonisht qeshet pak me ata që nuk janë pyetur. Qarkullo një fletë me emrat, adresat etj. dhe cakto një person që ta qarkullojë te të tjerët, pastaj shtype dhe shpërndaje në fund të seancës së trajnimit.



- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të aktivizojë dhe të zgjojë grupin, veçanërisht pas drekës ose pas një pushimi të gjatë.
 - Të formojë nëngrupe, ku secili të ketë një emër që mbahet mend lehtë, për të punuar në grup më vonë.



 **MJETET:**

Karrike të vendosura në formë rrethi; një karrike më pak se numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve dhe trajnuesit. Në qoftë se ka karrike të mjaftueshme, atëherë këto mund të vendosen më përpara në një mjedis tjetër, si, p.sh., në një dhomë ngjitur. Nëse nuk është e mundur një gjë e tillë, thuaju pjesëmarrësve që të sjellin karriket me vete.

 **KOHA:**

10 minuta.

 **ECURIA:**

1. Vendos për numrin e grupeve që nevojiten, pasi kjo do të përcaktojë edhe numrin e frutave që do të përzgjidhen. Bëj një rreth të mbyllur me karrike, me një më pak se numri i njerëzve që do të marrin pjesë në ushtrim.
2. Thuaju pjesëmarrësve të ulen në karrike. Trajnuesi fillon lojën duke qëndruar në mes. Shpjego se ky është një ushtrim nxehjeje dhe kërkon aktivizimin e tyre.
3. Lëri pjesëmarrësit që të emërtojnë aq fruta sa duhen për nëngrupet, p. sh., katër fruta nëse ju duhet të formoni katër grupe. Thuaji një personi të zgjedhë një frut, shoku ngjitur një frut tjetër, tjetri një tjetër e kështu me radhë, derisa të arrish numrin e kërkuar të nëngrupeve. Personi tjetër në rreth merr frutin e parë, i dyti të dytin e kështu me radhë derisa të gjithë, duke përfshirë edhe trajnuesin, kanë një emër fruti (p.sh., mollë, bostan, portokall, dardhë, mollë, bostan, portokall etj.).
4. Nëse është e nevojshme, mund të shkruani emrat e frutave në një tabak letre ose në dërrasë, veçanërisht nëse janë më shumë se 5 lloje frutash që duhen mbajtur mend.

(vazhdon në faqen tjetër)

13. SALLATA E FRUTAVE (vazhdim)



ECURIA:

5. Para se të fillosh, kërkoju të gjithë atyre që i përkasin grupit të portokallit të ngrenë duar lart, pastaj atyre të bostanit e kështu me radhë. Kjo i kujton secilit edhe njëherë emrin e frutit të cilit i përket.
6. Personi që është në mes thotë me zë të lartë emrin e një fruti. Të gjithë pjesëmarrësit që i përkasin atij fruti ndërrojnë karriket, pa përjashtim. Personi që është në mes, do të përpiqet të zërë një vend dhe duhet të arrijë të ulet, pasi i duhet të ecë gjysmën e distancës.
7. Ngelet një person në mes, i cili përsërit këtë proces, duke thënë me zë të lartë një frut tjetër. Kur janë përmendur të gjithë emrat e frutave që përbëjnë sallatën e frutave, atëherë të tërë duhet të kenë ndryshuar karriket.



KOMENTET:

Ky ushtrim mund të japë shumë kënaqësi. Pjesëmarrësit do të aktivizohen të gjithë në pak minuta në mes të një kaosi të organizuar. Nuk ka nevojë që dikush ta ndalë lojën dhe ju, si trajnues, duhet ta përfundoni lojën duke mbetur vetë në mes. Kjo është më e lehtë, pasi janë përmendur të gjithë emrat e frutave të "sallatës së frutave". Përfundoje ushtrimin dhe kërko që secili të kthehet në atë pjesë të sallës ku zhvillohet uorkshopi.

Cakto emra frutash për tryezat dhe kërko që secili të ulet sipas grupit të ri. Nuk bëhet raportim. Nëse kërkohet punë në grup në një fazë të mëvonshme, këto emra frutash mund të përdoren sërish (p.sh., "Të gjithë ananasët do të punojnë bashkë për ...").

Kjo lojë përzjen hierarkitë dhe i çlodh pjesëmarrësit. Gjithashtu, ndan shokët dhe kolegët në grupe të veçanta, pasi ata zakonisht tentojnë që të ulen pranë njëri - tjetrit në rreth.


Variantet e "sallatës së frutave" janë pa fund, duke përfshirë edhe "Xhunglën" ose "Kopshtin zoologjik" (me kafshë nga xhungla ose kopshti zoologjik), "Supa me zarzavate" ose "Lëngu i mishit" (tipet e zarzavateve ose mishrave), "Kokteili" (përzjerje pijesh), "Pylli" (tipet e pemëve), "Oqeani" (peshqit) dhe "Ylberi (ngjyrat).

Me qëllim që ta dyfishosh numrin e grupeve nga loja, merr "Xhunglën" dhe "Kopshtin zoologjik" dhe identifikoj femrat dhe meshkujt në blloqe. Të gjithë kafshët e një specijeje lëzivin bashkë, por kur formohen grupet: tigrat dhe tigreshat, luanët dhe luaneshat, formojnë grupe të veçanta. Në këtë mënyrë mund të formohen tetë grupe nga katër kafshë.

Për grupe shumë të mëdha, bëj më shumë se një rreth, në të cilët luajnë njëkohësisht.


Një mënyrë tjetër, e cila nuk kërkon të mbash mend është "Loja e meshkujve". Personi në mes thotë: "Unë kam një letër për ata që punojnë për një OJF ... jetojnë në fshat ... kanë veshur këpucë të zeza... etj.". Sikurse edhe në "Sallatën e frutave", të gjithë ata që plotësojnë njërin nga këto kritere, ndërrojnë vendet. Personi që mbetet në mes zgjedh një kriter tjetër për "dhëniën e letrës".


14. "A-TË" DHE "B-TË"

 **OBJEKTIVAT:** ■ Të gjallërojë grupin dhe të ndryshojë vëmendjen e pjesëmarrësve të tij.

 **MJETET:** Nuk nevojiten.


 **KOHA:** 5 -10 minuta.

-  **ECURIA:**
1. Lësho mesin e dhomës ose gjej një hapësirë të lirë jashtë dhe ftoi të gjithë të ulen atje.
 2. Kërko nga secili që të shikojë të tjerët dhe në heshtje të zgjedhë një person në grup, i cili është personi "A" dhe një tjetër që është personi "B". Tregoju që nuk ka kritere të veçanta mbi të cilat ta bazojnë përzgjedhjen e tyre. Përzgjedhja është tërësisht në dorën e tyre.
 3. Sapo secili ka bërë zgjedhjen e vet, thuaji të afrohet sa të mundi te personi "A", ndërkohë që rri sa më larg personit "B". Pjesëmarrësit inkurajohen që të lëvizin shpejt, por jo të shtyhen apo përplasen me të tjerët. Ndërkohë, mund t'ua bësh të qartë që në këtë lojë, rregulli kryesor është që "Nuk duhet të ushtrohet dhunë fizike!".
 4. Pas disa minutash, pjesëmarrësve u kërkohet që të ndalojnë dhe ta fillojnë procesin anasjelltas: ata ndjekin personat "B" dhe shmangin personat "A".

 **KOMENTET:** Pothuajse në çdo rast kjo lojë çon në formimin e grupeve ose të një vije të gjatë, ose "dragua", ose "gjarpër", pasi një person shkon pas një tjetri. Mund të luani variacione të kësaj loje, duke formuar në fillim grupin në një vijë ose "dragua", dhe të kërkosh nga pjesëmarrësit që janë në fillim të vijës të kapin bishtin. Pastaj mund ta ndalosh "dragoin", t'i kthesh njerëzit në një drejtim tjetër dhe pastaj bishti të kapë kokën.


Pavarësisht nëse përdor versionin me "A"-të dhe "B"- të ose me "dragoin", rezultati do të jetë i njëjtë: pjesëmarrësit do të qeshin shumë. I vetmi objektivi është që të krijosh një pushim argëtues, që gjallëron pjesëmarrësit gjatë trajnimit. Mund të të duhet t'ua thuash këtë pjesëmarrësve, pasi mund të presin që ky ushtrim të ketë ndonjë kuptim të veçantë.


15. LOJA ME NUMRAT

-  **OBJEKTIVAT:**
- Të ilustrojë fuqinë që ka komunikimi jo me gojë.
 - Të formojë grupe të reja.

 **MJETET:** Nuk nevojiten.






 **KOHA:** 10 –15 minuta.

-  **ECURIA:**
1. Më përpara numëro pjesëmarrësit. Përlogarit kombinime të ndryshme për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në grupe me përmasa të ndryshme (p. sh., për një grup me 50 persona, 10 grupe me 5 persona).
 2. Liro qendrën e sallës ose gjej një mjedis të lirë jashtë.
 3. Kërko që të gjithë pjesëmarrësit të rrinë bashkë, por të mos flasin.
 4. Kërko që të formojnë X grupe me Y njerëz sa më shpejt. Mund t'ua bësh të qartë që duhet të lëvizin shpejt, duke i inkurajuar dhe duke u thënë që të lëvizin shpejt. Pastaj, thuaju që të formojnë një kombinim tjetër me persona të tjerë. Vazhdo ta bësh këtë sipas listës që ke përgatitur.
 5. Përfundoje me numrin e grupeve të planifikuara që të duhen për seancën tjetër të uorkshopit.

 **KOMENTET:** Përzgjidh kombinime me numra të ndryshëm, sipas të cilëve pjesëmarrësit përzihen në grupe të madhësive të ndryshme. Kjo i detyron pjesëmarrësit që shumë shpejt të largohen nga grupe të caktuara dhe të bashkohen me grupe të tjera. Kjo përzjerje dhe përzgjedhje mund të vazhdojë për njëfarë kohe, derisa të jenë formuar grupet me numrin e pjesëmarrësve që kërkohen. Për shembull, në qoftë se ke një grup me 26 persona dhe dëshiron që të formosh grup me 5 persona për seancën tjetër, do të të duhet ta përfundosh “Lojën me numrat” me pjesëmarrës në 4 grupe me 5 persona dhe 1 grup me 6 persona ose një kombinim i ngjashëm me këtë. Prandaj, mund t’u kërkosh atyre që të formojnë vetë kombinacionet e mëposhtme derisa të arrish mënyrën që duhet:

- 2 grupe me 13 persona;
- 6 grupe me 4 persona dhe 1 grup me 2 persona;
- 6 grupe me 3 persona dhe 2 grupe me 4 persona;
- 3 grupe me t (?) persona dhe 1 grup me 5 persona;
- 2 grupe me 9 persona dhe 1 grup me 8 persona;
- 4 grupe me 5 persona dhe 1 grup me 6 persona - fundi.

16. LËVIZ NGA VENDI

-  **OBJEKTIVAT:**
- Të gjallërojë pjesëmarrësit.
 - Të nxisë përqendrimin dhe imagjinatën.
 - Të nxisë pjesëmarrësit që të marrin përgjegjësi gjatë trajnimit.
-  **MJETET:** Nuk nevojiten.
-  **KOHA:** 1 - 5 minuta.
-  **ECURIA:**
1. Liro qendrën e sallës ose gjej një mjedis të hapët jashtë.
 2. Secili anëtar i grupit udhëzohet që të zgjedhë dhe të rrijë në një vend të hapur.
 3. Udhëzoji njerëzit të ecin përreth dhe të bëjnë njërën nga veprimet e mëposhtme:
 - Thuaji “tungjatjeta” të gjithë atyre që kanë veshur rroba të kuqe.
 - Shih lart kur ecën.
 - Ec mbrapsht.
 - Hidhu ose kërcë.
 - Artikulo një tingull ose fëshkëlle.
 - Mbjaj njërin (ose të dy) sy (të) mbyllur.
 - Rri në një vijë sa më të drejtë.
 4. Kur thua fjalën “stop”, secili duhet të vrapojë në vendin ku ishte. Personi që arrin në vendin e vet i pari është drejtuesi (pasi lehtësuesi e vë re një gjë të tillë) dhe mund të udhëzojë grupin të bëjë atë që dëshiron ai.
-  **KOMENTET:**
- Kjo mund të jetë një lojë e këndshme, për sa kohë nuk zgjat shumë. Ndoshta mund të përfundohet, pasi të kenë pasur udhëheqës tre ose katër persona. Problemi është se njerëzit mund të ngulen në vendet e tyre.

17. LËVIZ NËSE

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të gjallërojë grupin.
 - Të thyejë akullin.
 - Të formojë grupe të reja.

👁️ **MJETET:** Nuk nevojiten, por mund të veprohet me karrike të vendosura në formë rrethi.

🕒 **KOHA:** 35 minuta.

- ✍️ **ECURIA:**
1. Thuaju pjesëmarrësve të ulen ose të qëndrojnë në formë rrethi.
 2. Shpjegoju ushtrimin dhe fillo vetë.
 3. Thuaj me zë të lartë emrin që ka një grup pjesëmarrësish, p.sh., duhanpirësit, zotëruesit e veturave, ata që mbajnë syze, njerëz që janë nga një qytet afër X, futbolldashësit etj., duke thënë: “Lëvizni nëse jeni ...”. Të gjithë ata që i përkasin një kategorie të caktuar, hyjnë në rreth.
 4. Pastaj thirr një kategori tjetër dhe thuajti njerëzve të lëvizin, nëse i përkasin asaj. Personat që janë në mes rrinë aty ose ulen, nëse nuk i përkasin asaj kategorie.
 5. Vazhdo ushtrimin më shpejt, me qëllim që të nxiten njerëzit të lëvizin.

🗨️ **KOMENTET:** Një lojë e gjallë dhe ku njerëzit lëvizin shpejt. Një variant tjetër mund të përfshijë çështjet që trajtohen në uorkshop. Për shembull:

- *Lëviz nëse dëshëron të fillosh herët në mëngjes.*
- *Lëviz nëse të duhet më shumë kohë për të punuar në grupe të vogla.*

Një variant tjetër është që të ndjekësh modelin e “Sallatës së frutave” (shih veprimtarinë nr. 13), me një karrike më pak sesa numri i pjesëmarrësve. Personi në mes thërret: “Lëviz nëse ke këpucë, gotë, vëthë, mjekër të zezë ...” dhe ata njerëz që i kanë këto, ndërrojnë vendet. Kjo lë një person në mes, i cili pastaj vazhdon me raundin e dytë. Një mënyrë tjetër është kjo: Lehtësuesi mbetet në mes gjatë gjithë kohës dhe përzgjedh kriteret që mund të ndajnë personat që kanë tendencë të rrinë gjithë kohës bashkë. Në fund, grupet mund të formohen thjesht duke numëruar pesë të parët që formojnë një grup, pastaj pesë të tjerët e kështu me radhë.


✓ **OBJEKTIVAT:** ▪ Të gjallërojë grupin.

👁️ **MJETET:** Nuk janë të nevojshme.

🕒 **KOHA:** 10 minuta.

- 📝 **ECURIA:**
1. Grupi i madh ndahet në katër ose në pesë grupe. Secili grup formon rreshta në formën e rrugëve, duke kapur duart në një drejtim. Rreshtat janë paralel me njëri - tjetrin.
 2. Kur thuhet “bulevarde”, pjesëmarrësit bëjnë një kthesë të vogël nga e majta dhe kapin duart e personave që janë në këtë çast pranë tyre. Kur jepet urdhëri “rrugët”, grupi shkon në pozicionin e mëparshëm.
 3. Thuaji dy vullnetarëve të marrin rolin e macës dhe të miut. Macja duhet të kapë miun. Vazhdo të japësh urdhëra për formimin e “rrugëve” dhe “bulevardeve”, me qëllim që ta mbash macen larg nga miu. Asnjëri nuk lejohet që të prishë rreshtin.

🗨️ **KOMENTET:** Të gjithë duhet të kundërveprojnë me shpejtësi, me qëllim që macja të mos e kapë miun. Ky është një ushtrim gjallërues, kështu që bëju të ditur pjesëmarrësve se ky është i gjithë qëllimi i lojës. Ky ushtrim mund të paraqesë vështirësi në mjedise të tilla kulturore, ku prekja e njëri - tjetrit është e papranueshme, sidomos midis burrave dhe grave.



19. ANËTARËT E FAMILJES



OBJEKTIVAT:

- Të gjallërojë grupin.
- Të formojë nëngrupe.



MJETET:

Rripa letre me emrat e familjeve dhe emrat e anëtarëve të familjes të shkruara në to, një për çdo pjesëmarrës.



KOHA:

5 minuta.



ECURIA:

1. Përgatit kartona me mbiemra familjesh në grupe me 4 ose 5 persona: nëna Bujku, babai Bujku, motra Bujku, vëllai Bujku. Përdor emra, p.sh., kafshë të ndryshme, zogi, fruta ose emra që tregojnë profesione, si: familja Mësuesi, familja Bankieri, familja Peshkatari etj.
2. Jepi secilit pjesëmarrës një rrip letre dhe kërkoni nga secili të ecë nëpër dhomë, duke shkëmbyer emrat, ndërsa takojnë njerëz të tjerë.
3. Thuaji që kur të thuash “Bashkimi Familjes” të gjithë duhet të formojnë një grup “të familjes së bashkuar”. Secili do të fillojë të thërrasë emrin e familjes që ka, në përpjekje që ajo të jetë e para.
4. Kërko nga grupi i fundit të formohet, kur dëgjon emrin e familjes.
5. Fillo edhe njëherë.
6. Kur e ndjeni se grupi është i gjallëruar dhe i çlodhur, ndalo dhe vazhdo me punën në grupe, duke ruajtur ndarjen e grupeve sipas emrave të familjeve.



KOMENTET:

Një variant tjetër është përdorimi i tingujve të kafshëve. Përgatit kartona të mjaftueshme, duke zgjedhur kafshët që kanë tinguj të dallueshëm dhe të ndryshëm (p.sh., pulë, dele, majmun, luan, qen). Kërko që pjesëmarrësit të bëjnë si kafsha që kanë në grupin e tyre, derisa të mblidhen të gjithë ata që i përkasin asaj “familje”.

Nëse ju duhet që t'i zgjidhni grupet sipas një qëllimi të caktuar, atëherë shkruani emrat e pjesëmarrësve mbrapa kartonave. Një mënyrë tjetër është që të mbash një listë me emra kafshësh, nëse dëshiron që t'i përdorësh kartonat sërish.

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të gjallërojë grupin.
 - Të tregojë nëpërmjet shembujve rëndësinë e koordinimit dhe të komunikimit.

👁️ **MJETET:** Nuk nevojiten.


🕒 **KOHA:** 15 minuta.


- 📝 **ECURIA:**
1. Ndaji pjesëmarrësit në grupe me madhësi të ndryshme.
 2. T'i kërkohet grupit A të depërtojë te grupi B. Asnjërit nuk i lejohej të flasë.
 3. Kur grupi A depërton te grupi B, të dy grupeve u thuhet se kanë dhjetë minuta për të planifikuar një depërtim të dytë ose mbrojtje.
 4. Përsërit këto përpjekje.

- 💬 **KOMENTET:**
- Kërko nga pjesëmarrësit të bëjnë dallimin midis të dy depërtimeve. I pari zakonisht ndodh pak më herët. I dyti është më i vështirë.
- Kërko nga pjesëmarrësit të nxjerrin rëndësinë e koordinimit dhe të komunikimit, dhe se çfarë mund të arrihet si grup, krahasuar me atë çfarë mund të bëjnë individë të veçantë.





21. NDAL STATUJËS

-  **OBJEKTIVAT:**
- Të gjallërojë njerëzit.
 - Të ndryshojë qendrën e vëmendjes.

 **MJETET:** Nuk nevojiten.

 **KOHA:** 15 – 20 minuta.

-  **ECURIA:**
1. Liro qendrën e sallës ose gjej një vend të lirë jashtë saj.
 2. Kërko nga pjesëmarrësit të formojnë dy rrethë me numër të barabartë njerëzish: rrethi i brendshëm me fytyra që shohin nga jashtë, i rrethuar nga rrethi i jashtëm me fytyra që shohin nga brenda.
 3. Secilit person në rrethin e jashtëm i jepen 5-10 minuta kohë për të formuar “figurën”, duke përdorur personin përballë në rrethin e brendshëm. Personi që është në rrethin brenda e lejon “skulptorin” të përkulet dhe të përdredhë trupin në çfarëdolloj forme që dëshiron (për sa kohë ata nuk e prekin atë). Sapo lëvizin, personi në rrethin brenda duhet të mbetet në atë pozicion, i ngrirë si një statujë, pa folur.
 4. Thuaji që të thonë fjalën “koha” ose të përplasnin duart; rrethi i jashtëm lëviz rreth një personi për nga e majta dhe ata fillojnë të krijojnë përsëri figurën. Personat që janë në rrethin brenda përkulen dhe përdridhen në pozicionet e reja nëpërmjet këtij procesi.
 5. Kjo përsëritet derisa të plotësohet i tërë rrethi.
 6. Pasi të ketë përfunduar rotacioni, rrethi brenda ndryshon bashkë me rrethin jashtë dhe ushtrimi përsëritet sërish.

 **KOMENTET:** Ky ushtrim mund të pëlqehet shumë. Megjithatë, për kultura të caktuara mund të mos jetë e përshtatshme që burrat dhe gratë të jenë në të njëjtat grupe. Në një rast të tillë, mund të formosh dy grupe të veçanta që luajnë lojën dhe një grup vëzhgon tjetrin gjatë ushtrimit.

Duhet t’u kujtoni pjesëmarrësve se nuk duhet të ushtrohet dhunë dhe se ata të gjithë kanë të drejtë që të kërkojnë të mos vihen në pozicione të sikletshme apo fyese. Sqarohi se ata duhet të respektojnë dhe, njëkohësisht, kanë edhe lirinë për t’u shprehur.

22. NUMRIMI I ANASJELLTË

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të gjallërojë pjesëmarrësit.
 - T'i ndihmojë që të konstatojnë ndikimin që kanë rregullat e thjeshta e të vendosura nga të tjerë.

👁️ **MJETET:** Nuk nevojiten.

🕒 **KOHA:** 5 minuta, ndoshta disa herë për një periudhë kohe prej dy ditësh.

- ✍️ **ECURIA:**
1. Kërko që pjesëmarrësit të ngrihen në këmbë dhe të formojnë një rreth. Kjo mund të bëhet në çdo vend, edhe në klasë, pa lëvizur orenditë, pasi askujt nuk do t'i kërkohet të lëvizë.
 2. Thuajui pjesëmarrësve: “Do të bëjmë një gjë shumë të thjeshtë ... numëroni deri në pesëdhjetë. Ka vetëm disa rregulla. Mos thoni “shtatë” ose ndonjë numër tjetër i cili është herësi i shtatës. Në vend të tij përplasni duart. Pasi të parplasen duart, rendi i numërimit kthehet anasjelltas. Nëse ndokush thotë shtatë ose një numër të shumëzuar me të, atëherë duhet të fillojmë nga e para.”
 3. Kur, në mënyrë të pashmangshme, dikush, pa dashur, thotë numrin shtatë ose herësin e tij, ose harron të ndryshojë kursin e numërimit, pasi dikush ka përplasur duart, atëherë fillo numërimin në një pjesë tjetër të rrethit.
 4. Pas disa minutash dhe pasi pjesëmarrësit kanë qeshur pakëz, ndalo ushtrimin dhe thuajui të gjithëve se do ta provojnë këtë ushtrim përsëri më vonë.
 5. Në një çast tjetër, kur njerëzit kanë nevojë të freskohen pakëz, bëje ushtrimin përsëri.
 6. Përsërite këtë 3 ore 4 herë para se të bëhet përmbledhja e seancës.


🗨️ **KOMENTET:** Kur bëhet përmbledhja, pyete grupin:

- *Përse ushtrimi ishte kaq i vështirë?*
- *Si mund të lidhet kjo me punën tuaj?*


Kur jep udhëzimet në fillim, grupi thotë: “Oh, kjo është shumë e lehtë! Eja ta bëjmë.” Por ata shpejt e kuptojnë se ajo, që të gjithëve u duket e lehtë, bëhet më e ndërlikuar kur ndryshojnë disa nga rregullat që përcaktohen nga të tjerët. Mësimi kyç që nxirret në këtë rast është se kur ndërveprojmë me njerëzit e asaj zone, shpesh u imponojmë atyre rregulla të cilat nuk njihen prej tyre, duke e bërë në këtë mënyrë të vështirë komunikimin efektiv.

23. USHTRIM PËR VETËZGJEDHJEN E GRUPIT

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të formojë nëngrupe bazuar në njohuritë dhe kriteret e vetë pjesëmarrësve.
 - T'i ndihmojë pjesëmarrësit të ndihen më shumë pjesë e grupit që kanë zgjedhur për të qenë pjesë e tij.

 **MJETET:** Kartona, gjilpëra me kokë, tabelë (ku mund të ngulen gjilpëra) dhe ngjitës prej letre (natriban).

 **KOHA:** 10 – 15 minuta.

 **ECURIA:**


1. Përdor teknikën e Breinstormit (stuhi mendimesh) me grupin për listën e kriterëve që mund të përdoren për të përzgjedhur grupet. Kriteret nuk duhet të paragjykoen, por duhet të pasqyrojnë kriterë objektive (si gjinia) ose shumëllojshmërinë e aftësive. Duket qartë që mund të zgjidhen shumë kriterë. Kërkojui atyre të thonë kriteret që përputhen me rastin, ndryshe procesi bëhet i pamanovrueshëm.

2. Pastaj, secili pjesëmarrës duhet të plotësojë një përmbledhje të shkurtër, sipas kriterëve të zgjedhura (gjininë, gjuhën, njohuritë për fushën, trajnimin profesional, interesat, aftësi të tjera që mund të ofrojë etj.).

3. Në qoftë se duhet të formohen dy grupe, zgjidh dy mure në sallën ku zhvillohet uorkshopi për grupin A dhe B. Kërkoju pjesëmarrësve që t'i ngjisin letrat, ku kanë shkruar përmbledhjet e tyre, në mur, në vendin më të përshtatshëm për ta, dhe aty ku aftësitë e tyre do t'i kontribuojnë grupit, me qëllim që të shkrihen dy grupe të ekuilibruara. Në qoftë se dikush e ndjen se aftësitë apo gjinia e tyre është përfaqësuar si duhet, ata duhet ta vendosin përmbledhjen e tyre në një mur tjetër. Secili nga pjesëmarrësit mund të lëvizë vetëm përmbledhjen e tij personale. Pjesëmarrësit mund të lëvizin kartonin e një personi tjetër, vetëm pasi të jenë konsultuar me të. Pjesa tjetër e grupit nxitet që të bisedojë për të krijuar një grupim të ekuilibruar.


“ **KOMENTET:** Pasi kanë lëvizur poshtë e lart, dy grupe shkrihen. Meqë pjesëmarrësit kanë biseduar vetë me këto grupe, ka më pak ankesa. Kriteret që duhet të dijë çdo trajnues janë përfshirë, bashkë me aftësitë e panjohura që mund të dalin, pasi janë plotësuar përmbledhjet. Është çasti i përshtatshëm për të kuptuar që secili ka se ç'të ofrojë. Mund të jetë edhe një mekanizëm nivelimi për grupin. Meqë vetëm individi mund ta lëvizë fletën, njerëzit mund të zgjedhin që të jenë me ose të ndarë nga individë të caktuar. Ky ushtrim mund të ndihmojë që të zhvillojë më tej dinamikën e grupit. Ai mund të pasohet me formimin e “Kontratës së Grupit” nëpërmjet Ushtrimit për Zgjidhjen e problemit në grup (nr. 31, pjesa II.).

24. SKULPTURA NË GRUP


 **OBJEKTIVAT:** ■ Të ilustrojë, në mënyrë jokërcënuese, ndërveprimin midis anëtarëve të grupit për një çështje individuale ose një temë të përgjithshme.

 **MJETET:** Nuk nevojiten.

 **KOHA:** 15 – 30 minuta.

 **ECURIA:**

1. Liro qendrën e sallës ose gjej një hapësirë tjetër jashtë saj.
2. Ju ose një person i caktuar nga grupi mund të krijojë “një skulpturë të gjallë”, duke përdorur anëtarët e grupit për të ilustruar një situatë ose problem të caktuar.
3. Kjo kërkon që njerëzit të vendosen në një pozicion të tillë që tregojnë atë që ndodh (si tensioni, sabotazhi, përjashtimi, përfshirja) midis dy ose më shumë njerëzve në grup. “Skulptori” mund t’i vendosë njerëzit në mënyrë të tillë ku disa janë “lehtësues”, “sabotatorë”, “të abandonuar”, e kështu me radhë.
4. Anëtarët e grupit që mbeten mund të provojnë që të gjejnë temën ose subjektin e skulpturës dhe rolet e ndryshme që u janë caktuar njerëzve.
5. Ju mund t’i lejoni anëtarët e tjerë të grupit që të bëjnë skulpturën e tyre për të treguar perceptimin (dhe pozicionin) e tyre ose të dikujt tjetër për ngjarjet (p.sh. skulptura e parë mund të ketë qenë pikëpamja e menaxherit të projektit, ndërsa e dyta mund të përfaqësojë pikëpamjen e një anëtari tjetër të grupit ose këndvështrimin e fermerit).
6. Grupit mund t’i duket me dobi përsëritja e këtij ushtrimi, duke treguar edhe njëherë “skulpturën e grupit ideal”. Diskutimi në grup mund të vijojë duke u mbështetur në atë se “si i shohim gjërat” përpos “si do të dëshironim t’i shihnim gjërat”.

 **KOMENTET:** Duhet të kontrollosh vazhdimisht se si ndjehen pjesëmarrësit gjatë këtij ushtrimi. Bëjua të ditur se secili mund të largohet nga pozicioni i tij, nëse nuk ndjehet mirë ose në qoftë se u duket që mësojnë më shumë duke vëzhguar sesa duke qenë pjesë e tij.

Ky ushtrim mund të jetë një ushtrim shumë i mirë për t’i bërë grupet të përfytyrojnë dhe skicojnë skenare ose ndërveprime të ndryshme midis grupit dhe njerëzve të atij qyteti, fshati, zone ose midis vetë anëtarëve të ekipit.



25. TEKNIKA E GRUPIT NOMINAL

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të gjenerojë ide dhe të arrijë konsensusin e grupit nëpërmjet procesit të zgjidhjes së problemit në mënyrë të strukturuar.
 - Të mbështetet në idetë dhe mendimet e secilit individ dhe t'i kombinojë ato për të arritur një gjykim kolektiv.

👁️ **MJETET:** Tre kartona me madhësi 7.5 dhe 12.5 për secilin anëtar grupi, tabelë ku ngulen gjilpëra.

🕒 **KOHA:** 2 – 2 ^{1/2} orë.

📝 **ECURIA:** Ecuria përbëhet nga katër etapa:

1. GJENERIMI I IDEVE NË HESHTJE

Objektivi i etapës së parë është që t'u japë kohë individëve të japin zgjidhje të mundshme për një problem të dhënë. Shpërndajini fletët e punës me përcaktimin e problemit të shkruar sipër dhe ju kërko anëtarëve të grupit që t'i përgjigjen problemit, duke përdorur fraza të shkurtëra me shkrim. Duke mos i lënë pjesëmarrësit që të flasin ose të lëvizin, i nxit ata të bisedojnë më seriozisht për problemin. Etapa e parë u jep kohë anëtarëve që t'i përgjigjen problemit, duke përdorur idetë e tyre.

2. RAPORTIMI I SHKURTËR I IDEVE

Kjo etapë i jep mundësi secilit anëtar të grupit të ndajë idetë e tij/e saj me të tjerët. Kërko që njëri prej tyre të raportojë një mendim me shkrim dhe ta shkruajë atë në një tabak letre, duke përdorur me saktësi fjalët e thëna nga personi. Pastaj, personi tjetër pyetet për një ide tjetër dhe kështu përsëritet procesi. Idetë merren me radhë përreth tryezës, derisa secili të jetë shprehur për idetë e veta. Nëse ndonjëri do që të mos përgjigjet, lehtësuesi kalon te personi tjetër. Kur idetë e shkruara në tabakun e letrës stimulojnë një ide tjetër me një pjesëmarrës tjetër, ky person nxitet që ta shtojë këtë ide në fletën e punës së tij/saj dhe ta raportojë para të gjithë grupit.

Secilës ide i vihet një etiketë me një gërmë të alfabetit. Etiketimi e bën shkallëzimin e zgjidhjeve më të lehtë në etapën e fundit.

Përpiqu që të mos thuhet idetë gjatë kësaj faze. Qëllimi i raportimit të shpejtë është të inkurajojë të gjithë pjesëmarrësit që të thonë idetë e tyre, veçanërisht ata që janë të druajtur, të cilët mund të dominohen nga ata që flasin më shumë.

(vazhdon në faqen tjetër)

25. TEKNIKA E GRUPIT NOMINAL (vazhdim)



ECURIA:

3. DISKUTIME PËR SQARIME

Kjo etapë krijon mundësi për diskutime të hapura dhe sqarimin e të gjitha ideve që kanë dalë. Nxiti anëtarët e grupeve të pyesin njëri - tjetrin për kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve që janë vënë në fletët e punës. Diskutimi mund dhe duhet të sqarojë kuptimin, logjikën apo mendimin për idenë e shprehur.

4. SHKALLËZIMI I PROBLEMEVE/ZGJIDHJEVE SIPAS SHKALLËS SË RËNDËSISË


Qëllimi i kësaj faze përfundimtare është që të kombinojë idetë dhe mendimet e secilit anëtar për të përcaktuar rëndësinë relative të problemeve apo zgjidhjeve që janë identifikuar. Gjatë kësaj etape, jepi secilit anëtar të grupit pesë kartona me madhësi 3 x 5 dhe kërkoji secilit person që të shënojë pesë artikuj (një për secilin karton), me prioritet më të lartë nga ato që janë radhitur në tabakun e letrës. Ata shkruajnë në karton një frazë dhe germën identifikuese të alfabetit. Pastaj, kërkoju anëtarëve të grupit të identifikojnë artikullin me rëndësi më të madhe sipas shkallës 5 – ajo me rëndësi më të madhe, 4 e kështu me radhë. Kartonat mbliidhen dhe pikët shënohen në fletën kryesore.


Rezultati përfundimtar i kësaj janë gjykimet e pavarura.

“ KOMENTET:


Individët që punojnë në grupe gjenerojnë më shumë ide sesa kur punojnë më vete. Është konstatuar se ato grupe, ku njerëzit bashkohen por nuk lejohen të komunikojnë, janë më efektive për gjenerimin e ideve sesa grupet që ndërveprojnë bashkë, ku njerëzit takohen dhe diskutojnë, hedhin mendime, shkëmbejnë informacion. Grupet ndërvepruese kanë tendencë që të pengojnë të menduarit kritik.

Është e rëndësishme që të shënohet se shkallëzimi i ideve në këtë mënyrë jokërcënuese dhe private, bën të mundur që të gjenerohet gjykimi i grupit, pa qenë i detyruar që të konformohesh si rezultat i presionit social.

-  **OBJEKTIVAT:**
- Të krijojë profilin e grupit lidhur me rolin që ka secili individ.
 - Të nxisë secilin grup të hartojë një strategji të vetën të bazuar në rolet dhe përgjegjësitë që kanë.

 **MJETET:** Fletë letre A 4 ku janë shkruar pyetjet A – K (shih më poshtë).

 **KOHA:** 30 minuta.

-  **ECURIA:**
1. Shpërndaji fletët duke i dhënë secilit nga një. Secili person në mënyrë anonime shënon tre nga njëmbëdhjetë pyetjet lidhur me atë se ç'mendon ai ose ajo për faktin se si po punon grupi.
 2. Mblidh fletët dhe pastaj ktheja ato secilit grup në mënyrë që të bëjë profilin e vet.
 3. Profili duhet të përmbajë një listë me rolet të cilat përfaqësohen mirë. Gjithashtu, duhet të theksojë se çfarë mungon.
 4. Grupet mund t'ia paraqesin profilet e tyre njëri - tjetrit dhe të marrin mendimin e tyre kur plotësojnë boshllëqet.

PROFILET E GRUPIT

Në grupe keni tendencën që

Shëno vetëm tri kuti

- A: Të rrini qetë për njëfarë kohe pastaj të merrni pjesë?
- B: Të mos ndieni rehat dhe keni dëshirë të punoni vetëm?
- C: Të merrni situatën në dorë dhe të strukturoni diskutimin?
- D: Të merrni rol drejtues?
- E: T'i inkurajoni të tjerët të kontribuojnë?
- F: Të krijoni ide të reja?
- G: T'i ndërprisni të tjerët që të siguroheni që se të kanë kuptuar?
- H T'i kujtoni grupit veprimet praktike dhe se duhet të arrijnë objektivat?

(vazhdon në faqen tjetër)

26. PROFILET E GRUPEVE (vazhdim)



ECURIA:

I: T'i bësh të gjithë të çlodhen dhe të nxisësh harmoninë?

J: Të nervozoheni dhe mërziteni kur flasin shumë, por nuk bëhet
aq sa duhet?

K: Të ndërhyjni tek ata anëtarë grupesh që gjithmonë kanë
kundërshti me njëri – tjetrin?

“ KOMENTET:

Ky ushtrim mbështetet në vlerësimin e ndershëm të secilit pjesëmarrës për të vlerësuar rolet e tyre, si dhe në anonimatim kur grupet shohin se cilat role janë të pranishme. Ai ndihmon për të gjeneruar ide dhe krijuar një atmosferë, ku secili mban qëndrim kritik ndaj aftësive të grupit të vet.

Ushtrimi me profilet e grupeve mund të pasohet nga ushtrimi “Zgjidhja e problemit në grup” dhe “Kontrata e grupit” (Nr. 31).

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të tregojë se sa me lehtësi mund të ndërpritet komunikimi dhe puna në grup.
 - Të krijojë një strategji grupi me anë të së cilës të njohë dhe të merret me sabotazhin.
 - Gjithashtu, si mjet për të vendosur me sukses barazinë dhe gjallërinë.

👁️ **MJETET:** Grupe me tri karrike.

🕒 **KOHA:** 15 minuta ose më gjatë, në varësi të kohës që duhet për të bërë komentet.

- ✍️ **ECURIA:**
1. Pjesëmarrësit ndahen tre e nga tre. Në secilin grup ata duhet të luajnë tri role: folësin, dëgjuesin dhe sabotatorin. Folësi dhe dëgjuesi rrinë përballë njëri - tjetrit dhe flasin, ndërsa sabotatori lëviz. Folësi i kërkohet që të përshkruajë disa aspekte të punës ose jetës së tyre. Sabotatori i kërkohet të përpiqet të sabotojë (ndërpresë) diskutimin në çfarëdo mënyrë, por jo duke ushtruar dhunë.
 2. Sabotorët që lëvizin, mund të lëvizin nëpër grupe. Sabotator mund të jenë trajnuesi dhe ndonjë tjetër që nuk u bashkua me grupin kur u bë ndarja e tij.



(vazhdon në faqen tjetër)

27. SABOTATORI (vazhdim)



ECURIA:

3. Pas dy minutash kërkoni nga pjesëmarrësit që të ndërrojnë rolet. Pastaj, përsëri pas dy minutash, pasi është e rëndësishme që të gjithë pjesëmarrësit t'i luajnë të gjitha rolet. Të gjithë duhet ta dinë se ç'ndjenjë të krijohet kur je sabotator dhe të sabotojnë.



KOMENTET:

Diskutimi pas këtij ushtrimi është shumë i rëndësishëm. Për të përcaktuar një strategji grupi, është e nevojshme që t'i ftohen pjesëmarrësit të shprehin se si u ndjenë.

- Si t'u duk vetja kur ishe sabotator dhe të sabotonin?
- T'u duk e lehtë apo e vështirë për të ndërprerë bisedën?

Pastaj, kërkoni që të thonë të gjitha tipet e sabotatorëve që kanë ndeshur më parë dhe shkruajni ato në një tabak letre. Shembujt përfshijnë: dominim, rreptësi, ndërprerje (pyetje/përgjigje), tallje dhe të qenit joserioz, pa edukatë, i heshtur, të folurit me entuziazëm dhe shkoputja fizike duke e trazuar tjetrin.

Pastaj kërkoni nga pjesëmarrësit të flasin për mënyrat se si mund të trajtohet sabotazhi, d.m.th. të sabotosh sabotatorët.

- Në ç'mënyrë jeni marrë ose si do të merreshit me sabotatorët?
- Cilat janë mënyrat që mund të përdorin grupet ndaj individëve që janë sabotatorë?

Shkruajni këto strategji në një fletë tjetër. Shembujt përfshijnë: injoroje me mirësjellje, ndërprite me mirësjellje/e qartë, ndalo diskutimin, flit me zë të lartë dhe në publik, bëja të ditur dhe shtyje, ndrysho vëmendjen, formo grupe të vogla ose përcakto detyra, përdor sabotatorin për debat, kërkoni ndihmë nga të tjerët, largohu. Këto mund të ngjiten në mur që t'i shikojnë të gjithë dhe mund t'u referohesh gjatë kohës së mbetur në uorkshop.

Ky ushtrim dhe diskutim mund të jetë në mënyrë të veçantë i vlefshëm, në qoftë se ka anëtarë në grupe që u shkopusin vëmendjen të tjerëve. Një ushtrim i tillë mund të jetë një mundësi e mirë për ta që të reflektojnë në sjelljen e tyre dhe për grupin që të zhvillojë mënyra se si të trajtohen rastet kur ka persona të tillë. Gjithashtu, ai mund ta përgatisë grupin mirë për situata kur intervistat në terren janë të vështira.

Akoma më i rëndësishëm është fakti që ky ushtrim i bën të ditur nocionin e sabotazhit të gjithë grupit, si dhe u vë theksin strategjive për t'u marrë me të. Gjatë kohës së mbetur në uorkshop, ka gjasa që pjesëmarrësit mund të arrijnë në vendosin njëfarë rregulli pa ndihmën e trajnuesit. Sa herë që ka ndërprerje në grup, do të thuhet fjala "sabotator".


- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- T'u demonstrojë pjesëmarrësve që grupet e aftësuara për të zgjidhur problemet e tyre janë shumë më të suksesshme sesa kur udhëzohen nga jashtë.
 - Të gjallërojë grupin.

👁️ **MJETET:** Nuk nevojiten.

🕒 **KOHA:** 10 – 15 minuta.

✍️ **ECURIA:**

1. Zgjidhni një, dy ose tre pjesëmarrës që të luajnë rolin e menaxherit. Atyre u kërkohet që të dalin nga salla, ndërkohë ju i jepni udhëzimet pjesës tjetër të grupit.




2. Kërko nga pjesëmarrësit që kanë mbetur që të qëndrojnë në formë rrethi dhe të shtrijnë duart e t'i kapin ato me duart e një tjetri, duke formuar një lëmshi. Nuk duhet t'i lëshojnë duart, sado në siklet të jenë.
3. Thuaju pjesëmarrësve që të ndjekin udhëzimet e menaxherëve fjalë për fjalë dhe të mos bëjnë gjëra që nuk u janë thënë.
4. Sapo të jetë bërë nyja, menaxherët të kthehen dhe të shkokolepsin lëmshin brenda tri minutave, duke përdorur udhëzime vetëm me gojë.
5. Udhëzoji menaxherët që t'i mbajnë duart mbrapa shpine. Ata nuk kanë të drejtë ta prekin grupin, por vetëm të japin udhëzime me gojë.
6. Herën e parë, zakonisht loja nuk është e suksesshme dhe ngandonjëherë krijon një lëmsh edhe më kompleks. Përsëriti ushtrimin ku marrin pjesë menaxherët në lëmsh. Kur lëmshi është gati, thjesht thuaju pjesëmarrësve “të dalin nga lëmshi vetë”.

“ **KOMENTET:** Zakonisht, procesi i dytë i zgjidhjes së lëmshit është shumë më i shpejtë. Kërkoju pjesëmarrësve të komentojnë se sa lidhet ky ushtrim me realitetin tonë. Mund të ngresh disa çështje:


- Çfarë na tregon kjo lojë lidhur me rolet e të huajve/menaxherëve dhe njerëzve që janë në të?
- Çfarë na tregon ne ky ushtrim lidhur me efektivitetin e “të jashtëmve” dhe “menaxherëve” në organizimin e njerëzve?
- Çfarë tregon loja për nxitjen e pjesëmarrjes në zhvillimin e komunitetit?


29. ECJA ME BESIM

-  **OBJEKTIVAT:**
- Të ilustrojë rëndësinë e besimit në mënyrën se si i ndërtojnë njerëzit marrëdhëniet.
 - T'u japë mundësi individëve të shohin drejtimin e tyre dhe aftësitë për të krijuar raporte.

 **MJETET:** Nuk nevojiten.

 **KOHA:** 40 minuta.

-  **ECURIA:**
1. Ndaji pjesëmarrësit në çifte duke iu kërkuar atyre që të zgjedhin dikë me të cilin ende nuk kanë punuar.
 2. Në secilin çift njëri drejton dhe tjetri ndjek atë, duke i mbajtur sytë mbyllur. Drejtuesi e merr personin që e ndjek, duke i vënë një dorë në shpatull ose nënbra, duke e drejtuar nëpërmjet dorës së mbështetur tek ai.
 3. Ushtrimi zhvillohet në qetësi (mund të ketë muzikë të lehtë në sfond).
 4. Drejtuesi e lëviz pasuesin e tij përreth sallës, sipas hapave të pasuesit dhe e bën që të prekë, ndjejë, mbajë, t'i marrë erë çdo objekti që gjendet aty ose sipërfaqeje (këto mund të përfshijnë objekte dhe njerëz).
 5. Ndërkohë që trajnuesi mund të bëjë ndërhyrje edhe me zhurma, erëra dhe objekte të tjera, për të ngritur shkallën e ndjeshmërisë.
 6. Pas 10 minutash, partnerët ndërrojnë rolet.
 7. Komentet mund të bëhen në grupin e madh ose në çifte të reja.

 **KOMENTET:** Pasi janë bërë të dy rolet, pjesëmarrësit pyeten se si u ndjenë në të dy rolet. Gjatë analizës, diskuto çështje të tilla, si besimi, ndërgjegjja, dialogu i brendshëm, tingujt, erërat, prekja, ndjenjat, figurat mendore, ndërtimi i raporteve.

Zona që zgjidhet për ushtrimin duhet të jetë e sigurt dhe ku ndërhyrjet nga jashtë janë të pamundura.

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- T'u japë ekipeve pjesëmarrëse në terren mundësinë të krijojnë normat dhe sjelljet e tyre.
 - Të krijojë kontratat në ekip.

👁️ **MJETET:** Fletë të parapërgatitura ku të jetë shkruar “Çfarë do të bëje nëse?”

🕒 **KOHA:** 45 – 90 minuta.

- ✍️ **ECURIA:**
1. Ndaji pjesëmarrësit në grupe të vogla deri në pesë persona. Mendohet që këto do të jenë grupet që do të punojnë bashkë në terren.
 2. Shpërndaj grupet e parapërgatitura me pyetjet. Nëse ke më shumë se një grup, caktoi disa pyetje specifike secilit grup (shih shembujt me katër grupet poshtë). Kërkoju të kenë parasysh se çfarë do të bënin ata nëse do të ndesheshin me këto probleme në terren.
 3. Kur secili grup ka marrë parasysh strategjinë për t'u marrë me secilin problem, kërkoju atyre të raportojnë në grupin e madh. Kur janë diskutuar të gjitha problemet, duke përfshirë komentet nga nëngrupet e tjera, kërkoju secilit grup që të bëjnë një marrëveshje midis tyre për një kontratë grupi. Kjo kontratë grupi bazohet në diskutimet dhe do të shërbejë si kod i sjelljes në terren.
 4. Pasi është bërë kontrata e grupit, nxiti të gjithë që të shkruajnë mbrapa fletorese të terrenit. Mund t'u kërkojë që ta ndajnë atë me grupet e tjera.

“ **KOMENTET:** Pyetjet duhet të përmbajnë probleme të ndryshme që lidhen me punën në terren si për dinamikën në grup, ashtu edhe vështirësitë që lidhen me përdorimin e metodave pjesëmarrëse në terren. Të gjitha 27 pyetjet e dhëna si shembuj, janë problemet që kanë dalë konkretisht në punën në terren.

Suksesi i këtij ushtrimi qëndron në parashikimin e problemeve që lidhen me punën në terren dhe trajtimin e tyre para se ato të ndodhin. Në këtë mënyrë, grupet do të dinë më mirë se çfarë duhet të bëjnë kur krijohen situata të tilla. Zakonisht, diskutimi zhvillohet midis pjesëmarrësve që kanë përvojë në terren, pasi ata do të ilustrojnë problemet dhe strategjitë me anë të shembujve të tyre gjatë kësaj përvoje.

Të pasurit e një kontrate në fletoren e tyre do të thotë se anëtarët e grupeve që janë problematikë, mund të nxiten më mirë që thjesht ta shikojnë atë dhe t'i përmbahen kontratës së tyre, sesa të konfrontohen drejtpërsëdrejti me sjelljen e tyre. Këto “rregulla” ndihmojnë që ta orientojnë grupin në raste krizash të vogla, pasi anëtarët i kërkojnë njëri - tjetrit që “të kujtojnë rregullin 9” ose thjesht të thonë: “Kontrata e grupit”.

(vazhdon në faqen tjetër)

30. USHTRIMI ZGJIDHJA E PROBLEMIT NË GRUP DHE KONTRATA NË GRUP (vazhdim)

“ KOMENTET: Pyetje tip për zonat rurale

GRUPI 1: Çfarë do të bënit në qoftë se:

1. Në një intervistë me grup të vogël të intervistuarit janë shumë të heshtur, nuk përgjigjen dhe nuk kanë dëshirë t'u përgjigjen pyetjeve të tua?
2. Në mes të intervistës me një grup të vogël disa nga fermerët thonë se duhet të ikin se kanë punë të tjera?
3. Një anëtar i grupit tuaj vjen me vonesë në mëngjes dhe anëtarët e tjerë të grupit janë të nervozuar?
4. Një anëtar i grupit është tejet entuziast dhe vazhdimisht i ndërpret fermerët kur flasin?
5. Ditën e fundit të punës në terren del një informacion shumë i rëndësishëm, i cili bie në kundërshtim me një rezultat të arritur?
6. Në mbledhjen ku bëhet analiza me fermerët, drejtuesi lokal përpiket të kontrollojë prioritetet e studimit?
7. Ju vini në planifikimin e komunitetit me mendimin që të përcaktoni hartën e gjërave dhe t'i modeloni ato, por grupi është në siklet dhe i pasigurt, dhe nuk di nga t'ia fillojë?


GRUPI 2: Çfarë do të bënit në qoftë se:


1. Një fermer ju thërret, ndërkohë që ju po ktheheni në automjetin tuaj me mendimin që të hani ose pini diçka?
2. Përballë një grupi fermerësh, një anëtar i grupit kundërshton atë çfarë ka thënë një fermer tjetër pak më parë?
3. Shumica e njerëzve në fshatin në të cilin ju keni punuar mendon se gjenerimi i të ardhurave, ruajtja e tokës dhe ujit, dhe rrugët e fshatit janë më të rëndësishme sesa puna ku është fokusuar institucioni juaj?
4. Një anëtar i grupit shpesh kritikon në diskutimet në grup?
5. Në fund, ju e kuptoni se janë intervistuar shumë pak gra, ndonëse duket sikur ato janë aktive në veprimtaritë bujqësore në atë zonë?
6. Njëri nga anëtarët e grupit dëshiron të largohet një ditë para se të mbaroni punën në terren?
7. Një anëtar i nivelit të lartë i organizatës ku ju punoni dëshiron të ndjekë punën në terren për të parë metodat pjesëmarrëse por, meqë di pak për qëndrimet që kërkohen në rastet e pjesëmarrjes së mirë, keni frikë se mos thjesht ju mban leksion fermerëve?

31. KARRIKET

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- T'u tregojë pjesëmarrësve se si të menaxhojnë konfliktin nëpërmjet kooperimit.
 - T'i ndihmojë ata që të fokusohen në ndryshimet e mundshme në interpretimin e udhëzimeve.
 - T'i ndërgjegjësojë pjesëmarrësit për ndryshimet kulturore që ekzistojnë në trajtimin e konfliktit.

 **KOHA:** 30 – 45 minuta.

 **MJETET:** Tre udhëzime (shih më poshtë), kopje të secilit për një të tretën e pjesëmarrësve. Një dhomë pa tryeza, por me karrike për secilin pjesëmarrës.

-  **ECURIA:**
1. Shpjegoju pjesëmarrësve lidhjen e këtij ushtrimi, duke iu referuar objektivave të tij. Pastaj jepi secilit pjesëmarrës një grup udhëzimesh (ose A, B ose C), duke shpërndarë në mënyrë të barabartë tre udhëzime të ndryshme. Thuaju atyre që të mos t'ia tregojnë copëzën e letrës pjesëmarrësve të tjerë, pasi kjo dëmton qëllimin e ushtrimit.
 - A. Vendosi të gjitha karriket në formë rrethi. *Keni 15 minuta kohë për këtë.*
 - B. Vendosi të gjitha karriket pranë derës. *Keni 15 minuta kohë për këtë.*
 - C. Vendosi të gjitha karriket pranë dritares. *Keni 15 minuta kohë për këtë.*
 2. Trajnuesi u thotë të gjithëve të fillojnë ushtrimin, pasi janë dhënë udhëzimet.

“ **KOMENTET:** Analiza fokusohet në aspektet e zgjidhjes së konfliktit në mënyrë joagresive. Udhëzimet nuk mund të zbatohen, nëse njerëzit që marrin udhëzime të njëjta nuk bashkëpunojnë. Grupet e vogla nuk mund t'i zbatojnë udhëzimet, në qoftë se ato nuk bashkëpunojnë. Janë disa zgjidhje të mundshme:

1. Vendosja e të gjitha karrikeve në një rreth, midis derës dhe dritares.
2. Vendosja me radhë e karrikeve në formë rrethi, pastaj pranë derës, pastaj pranë dritares.
3. Të mos i bindesh një pjese urdhëruese, duke vendosur një të tretën e karrikeve në formë rrethi, një të tretën pranë derës dhe një të tretën pranë dritares.

(vazhdon në faqen tjetër)

31. KARRIKET (vazhdim)

4. Ndërrimi i emrit të situatës, duke varur dy tabela në mes të dhomës në një rën prej të cilave është shkruar “dritarja” dhe në tjetrën “dera”.
5. Të mos i bindesh fare udhëzimeve që jepen.

Ky ushtrim jep dorë për zgjidhjen e konfliktit në mënyrë krijuese. Grupet shpesh egërsohen, përdorin forcën dhe ngandonjëherë i mbajnë karriket apo ulen në qoshen e ture. Në rastet kur disa nga pjesëmarrësit përpiqen ta zgjidhin konfliktin nëpërmjet bashkëpunimit, mund të shikosh që të tjerët vazhdojnë të mbledhin apo mbrojnë karriket e tyre. Kjo e cënon bashkëpunimin, duke bërë që ata të harrojnë qëllimet e mira dhe të bashkohen me argumentin.


Pyetjet që lidhen me analizën përfshijnë:

- *Cila ishte përvoja jote gjatë kësaj loje?*
- *A ndjeve që karrikja mbi të cilën ishe ulur ti, ishte e jotja e që mund të bëje ç'të doje me të?*
- *Si komunikove me njerëzit që donin diçka tjetër? A bashkëpunove, nxite, debatove, luftove apo u dorëzove?*
- *Nëse ju kundërvure të tjerëve, si e bërë këtë?*
- *A i ndoqe udhëzimet? Përse i interpretove ato në atë mënyrë? A i pe ato si udhëzime që duheshin zbatuar, pavarësisht nga kostoja që mund të kishin dhe duke përjashtuar të tjerët?*
- *Si ndiheni për udhëzimet e ndikuara nga traditat tuaja? A ka ndikuar kultura juaj në mënyrën se si u sollët në këtë rast?*
- *Si do ta trajtoje një detyrë të tillë, nëse do ta bëje për herë të dytë?*
- *A mund ta lidhësh atë çfarë ndodhi këtu me situata konkrete jetësore?*

“ KOMENTET:

- ✓ **OBJEKTIVAT:** ■ Të demonstrojë që grupet mund të zhvillojnë strategji konkurruese dhe bashkëpunuese, duke shfrytëzuar besimin, efektet e tradhëtisë ndaj besimit, efektet e konkurrencës dhe procesin e zhvillimit të bashkëpunimit.

👁️ **MJETET:** Lapsa, letër.



🕒 **KOHA:** Rreth 60 minuta.

- 📖 **ECURIA:**
1. Ndaji pjesëmarrësit në grupe me numër çift. Shpjego që objektivi i lojës është që çdo grup të arrijë sa më shumë pikë.
 2. Grupet çiftohen (një grup A dhe një grup B, duke luajtur kundër njëri - tjetrit) dhe udhëzohen që mos të komunikojnë me grupin tjetër në asnjë mënyrë: gojarisht, jogojarisht, përveçse në rastet kur iu thuhet që të komunikojnë. Ata mund të bisedojnë midis tyre që të zgjedhin ndërmjet “strategjisë së kuqe” ose “strategjisë blu”. Fjalët e kuqe ose blu shkruhen në kartona të veçantë dhe secili grup merr njërin prej tyre. Tregoju grupeve sa pikë do të marrin në rastet e përshkruara më poshtë (shih pikën 4).

(vazhdon në faqen tjetër)

32. STRATEGJITË NË GRUP - DILEMA E TË BURGOSURIT (vazhdim)



ECURIA:

- Fillojnë raundet në të cilat secili grup zgjedh midis strategjisë së kuqe dhe asaj blu. Cakto një kufi kohor prej tre minutash për secilin raund. Kur mbaron koha për secilin raund, grupet ngrajnë lart kartonat, në mënyrë që të shohin të gjithë vendimin e grupit.
- Në fund të secilit raund, numërohen pikët për secilin grup dhe pastaj shënohen duke u bazuar në:
 - të dy grupet zgjedhin ngjyrën e kuqe - të dy fitojnë 2 pikë;
 - të dy grupet zgjedhin ngjyrën blu - të dy fitojnë 1 pikë;
 - një grup zgjedh ngjyrën blu dhe tjetri ngjyrën e kuqe - ngjyra blu fiton tre pikë dhe e kuqja 0;
- Në raundin e katërt dhe të tetë, grupet lejohen të konsultohen me njëri - tjetrin.
- Pas raundit të dhjetë, përlogariten pikët e fundit dhe pastaj bëhet raportimi i tyre.



KOMENTET:


Rezultati normal është që të dy grupet bien në ujdi të zgjedhin ngjyrën e kuqe për të marrë maksimumin e pikëve dhe, pastaj, njëri grup ose të dy luajnë me ngjyrën blu. Fituesit marrin tre pikë dhe grupi që ka gjithmonë kartela me ngjyrë të kuqe merr zero pikë. Në këtë mënyrë, grupet do të përpiqen që të zgjedhin ngjyrën e kuqe në fillim. Ka dy skenarë (1) besimi midis grupeve, i cili dalëngadalë ulet, derisa secili është i vendosur që të mashtrojë ose (2) besimi forcohet dhe fiksohet nga një lloj marrëveshjeje e ndërsjelltë.

Në fund, trajnuesi krahason pikët e secilit grup, pikët sipas palëve të kombinuara dhe pikët në përgjithësi. Maksimumi që fiton secili grup është 30 pikë, (në qoftë se ai çdo herë zgjedh ngjyrën blu dhe grupi me të cilin ai grup është çiftuar zgjedh ngjyrën e kuqe), maksimumi i pikëve sipas palëve të kombinuara është 40 pikë (në qoftë se secili grup zgjedhi çdo herë ngjyrën e kuqe). Variantet e kësaj loje përfshijnë vetëm dy grupe, të cilët dërgojnë përfaqësuesit e tyre në raundet katër dhe tetë, dhe njoftojnë se pikët do të dyfishohen në këto faza.

✓ **OBJEKTIVAT:** ■ Të përjetojë dhe analizojë disa nga elementet e bashkëpunimit, që individët të shikojnë sjelljen e tyre kur punojnë në grupe.

👁️ **MJETET:** Një tryezë për secilin grup të përbërë prej pesë personash dhe pesë zarfa që përmbajnë pjesëza kartoni sikurse tregohet në figurën më poshtë.

🕒 **KOHA:** Rreth 1 orë (5 minuta prezantim, 20 minuta detyrë dhe 20-30 minuta vlerësim).



✍️ **ECURIA:**

1. Përgatit kartonat. Për secilin grup të përbërë prej pesë personash do t'ju duhen pesë zarfe, mbi të cilat janë shkruar gerrat A, B, C, D dhe E., dhe pesë copëza kartoni 15 cm katror. Është mirë në qoftë se secili grup ka ngjyrë të ndryshme dhe në qoftë se zarfet ngjyrosen sipër (zarfet me gerrën A ngjyrë rozë, po kështu edhe zarfet me gerrat B, C etj.). Për shembull, secili grup pret pesë katrorët e vet saktësisht siç tregohet në figurë. Të gjitha copat nuk janë as në qoshe, as në mes të anës. Është e rëndësishme që t'i masësh dhe presësh ato me saktësi. Etiketoji pjesëzat siç tregohet dhe vendosi pjesëzat në zarfin përkatës.

2. Filloje ushtrimin duke shpjeguar se ushtrimi na jep mundësinë të shohim se çfarë është esenciale që grupi të bashkëpunojë në mënyrë të suksesshme. Kërkoju pjesëmarrësve të formojnë grupe me nga pesë vetë dhe të ulen përreth tryezës. (Është e mundur të kihet një person shtesë për të vëzhguar grupin).

(vazhdon në faqen tjetër)

33. KATORRËT BASHKËPUNUES (vazhdim)



ECURIA:

3. Pastaj lexoju udhëzimet para gjithë grupit.

“Secili nga ju ka një zarf, i cili ka pesë copëza kartoni për të formuar katrorë. Kur unë të jap sinjalin për të filluar, çdo grup ka për detyrë të formojë pesë katrorë. Ka dy rregulla të rëndësishëm:

- 1. asnjëri nuk duhet të flasë apo të japë sinjal – detyra duhet të kryhet në heshtje;*
- 2. asnjëri nuk mund të marrë apo të kërkojë copë kartoni nga ndonjë person tjetër, por ata mund t’i japin copëza të tjerëve.*

4. Detyra quhet e kryer atëherë kur secili individ ka para vetes një katror të saktë, me po të njëjtin madhësi, si të atyre që kanë anëtarët e grupeve të tjera.

“ KOMENTET:

Kur e sheh diagramën e pesë katrorëve, duket shumë e lehtë. Por pjesëmarrësit në trajnim zakonisht përftojnë deri tre ose katër katrorë dhe disa copëza çift të cilat nuk përputhen me njëra - tjetrën. Pjesëmarrësit e kuptojnë që dëshira e secilit prej tyre për të formuar një katror është sekondare për grupin, krahasuar me atë që i gjithë grupi duhet të formojë pesë katrorë. Suksesi personal nuk është gjithmonë i barabartë me suksesin e gjithë grupit dhe aktualisht mund të pengojë realizimin e objektivit të grupit. Një zgjidhje e mirë për një person në fakt mund të pengojë arritjen e zgjidhjes më të mië për të gjithë grupin.

Brenda rregullave të lojës, secili grup mund të nxjerrë rregullat e veta. Për shembull, të gjithë anëtarët mund të vendosin (pa folur ose pa bërë gjeste) që t’ua japin të gjitha copëzat e tyre të tjerëve. Pastaj, atij personi nuk i duhet të presë të tjerët që t’i japin një nga një copëz, pasi është e pamundur që të përfitosh nga ndihma e të tjerëve.

Është e rëndësishme të harxhosh pak kohë që të marrësh mendime për këtë ushtrim. Trajnuesi mund të marrë përgjigjet nga grupet duke pyetur:

- Çfarë ndodhi? A u arrit detyra në një kohë të shkurtër? Përse jo?
- A bashkëpunoi grupi? Nëse do të kishte më shumë bashkëpunim, a do të kryhej ai më me shpejtësi?
- Çfarë roli luajtën njerëz të ndryshëm në grup?
- A u ndje ndonjëri i shqetësuar? Si e trajtoi ai këtë?
- A i theu ndonjëri rregullat? Në ç’mënyrë?
- Çfarë vunë re vëzhguesit?


Kjo mund të jetë një çështje e rëndësishme për të diskutuar rolet që luajtën anëtarë të ndryshëm në grup (shih Kapitullin 3).

34. ENIGMA ME KARTOLINA OSE ME COPËZA FIGURASH

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të gjallërojë pjesëmarrësit dhe të formojë një numër koherent me grupe të vogla prej grupit të madh.
 - Të analizojë se si vetorganizohen grupet.

 **MJETET:** Një sasi fotografish, si kartolina me kafshë, në atë sasi sa është numri i grupeve.

 **KOHA:** 5 - 10 minuta.

-  **ECURIA:**
1. Përgatit fotografitë. Këto priten në forma të ndërlikuara ose në copëza, në atë numër sa është numri i pjesëtarëve të grupit. Një grup me 20 persona, duhet ndarë në 4 grupe të vogla; nevoiten 4 figura dhe secila figurë duhet të ndahet në 5 pjesëza (p.sh., $4 \times 5 = 20$). Në qoftë se grupet janë të mëdha, atëherë copëzat do të jenë të vogla, kështu që sigurohu që figurat të jenë të qarta, për ta bërë detyrën më të lehtë. Në qoftë se grupet janë të vogla, atëherë pjesëzat do të jenë të mëdha, kështu që figura të ngjashme do ta bëjnë detyrën më interesante.
 2. Të 20 pjesëzat përzjehen dhe secilit pjesëmarrës i jepet një pjesëz.
 3. Pastaj grupit i kërkohet që të gjejnë grupet e tyre, duke bashkuar copëzat e duke formuar një figurë, pa folur me njëri - tjetrin.
 4. Me t'u formuar figurat, mund të vazhdoni me çfarëdo veprimtarie tjetër në grup që kishit planifikuar. Mund të mblidhni copëzat për t'i përdorur përsëri, por të kuptoni që grupet duan t'i mbajnë si identitetin e grupit.

“ **KOMENTET:** Në qoftë se loja me copëza figurash përdoret për të formuar grupe për punën në terren, atëherë figurat mund të përdoren për të strukturuar grupet sipas kriterëve të rëndësishme. Përcakto se kush duhet të jetë në secilin grup, përpara se të fillojë loja. Shkruaj emrat e secilit pjesëmarrës në copëzat, sipas grupit në të cilin do të punojnë. Kjo është me dobi për të praktikuar emrat, ndërkohë që ia shpërndan copëzat vetë personit përkatës. Zgjidh figura me anë të të cilave mund të identifikohen grupet gjatë punës në terren, si, p.sh., figura kafshësh – grupi i luanit. Nëse përdoren për këtë qëllim, ato zakonisht nuk mund të përdoren sërish, pasi grupet shpesh i lidhin figurat me simbolin e tyre.

(vazhdon në faqen tjetër)

34. ENIGMA ME KARTOLINA OSE ME COPËZA FIGURASH (vazhdim)


“ KOMENTET:

Një variant tjetër është që të mos i udhëzosh pjesëmarrësit të rrinë të heshtur; ngandonjëherë gjallëria dhe hareja në formimin e figurave ndihmon për të krijuar një atmosferë aktive për sesionin tjetër të uorkshopit.

Kjo lojë mund të shërbejë thjesht si një mënyrë që pjesëmarrësit të lëvizin nëpër sallë dhe të formojnë grupe të reja. Sidoqoftë, gjatë analizës, trajnuesi mund të analizojë se si u organizuan grupe të ndryshme.

- Si u takuan anëtarë të ndryshëm?
- Cilat ishin pengesat që u krijuan nga mungesa e komunikimit me gojë?
- A pati ndonjë organizator të grupit?
- Sa njerëz po prisnin që të vinin njerëz të tjerë tek ata?
- A pati ndonjë që thjesht u ul dhe thërriste emrat e figurës së tij (ose të kafshës) dhe priste që të tjerët të vinin tek ai?


Mos harro se vetëm me 5 ose 6 njerëz për një figurë, formimi i grupeve kryhet shumë shpejt. Një mënyrë për ta bërë formimin e grupeve më të vështirë dhe më të gjatë, është zgjedhja e figurave që janë nga të dyja anët (p.sh., 2 figura për një grup me 30 persona). Formimi i figurës zgjatet më shumë dhe kjo krijon mundësi për të nxjerrë tipat e njerëzve në grupe gjatë vërejtjeve konstruktive në fund. Kërko nga pjesëmarrësit që të nxjerrin se cilat ishin llojet e ndryshme të sjelljeve ose tipave të njerëzve që u zbuluan gjatë ushtrimit. Kjo mund të përfshijë një kryetar ose udhëheqës të natyrshëm, dikë që vjen rrotull për të mbledhur njerëzit, dikë që ulet dhe pret që të tjerët të vinë tek ai. (Për më shumë hollësi rreth roleve, shih Kapitullin 3, në mënyrë të veçantë Kutinë 3.7.)




35. SHIH SE KUSH PO FLET

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të analizojë dinamikën e diskutimit në grup.
 - Të nxjerrë në pah njerëzit që dominojnë ose që janë të izoluar në diskutimin në grup.

 **MJETET:** Letër dhe stilolaps.

 **KOHA:** Aq kohë sa merr një diskutim i veçantë (ose një pjesë e tij).

 **ECURIA:** Pas diskutimeve, analizohet modeli që krijohet. Mund të bëhen pyetje të ndryshme për analizën.

- *Ku ulen folësit kryesorë?*
- *Janë meshkuj apo femra?*
- *A folën shumë "keq" apo kryenin funksionin e lehtësuesit?*
- *Ku ulen ata që nuk flasin?*

“ **KOMENTET:** Ky ushtrim mund të përdoret në uorkshop me pjesëmarrësit ose në terren për të analizuar diskutimin në grup. Janë të mundshme disa alternativa:


- Përcaktimi i drejtimeve të bisedimit duke vizatuar viza ose shigjeta midis njerëzve në diagramë, për të treguar se me cilin person po flet një person i caktuar.
- Përlogaritja e kohës faktike në të cilën foli secili person, në secilin rast dhe regjistrimi i saj. Gjithashtu, përdorimi i kodeve për të treguar nëse kontributi përfundoi në mënyrë vullnetare apo u ndërpre. Kjo mund të reflektojë në dominim brenda grupit.


Kjo metodë mund të përdoret gjatë diskutimeve në grup në terren. Vetëm cakto një person që të regjistrojë këto të dhëna dhe pastaj analizo rezultatet menjëherë pas mbledhjes.


36. KATRORI PREJ LITARI

 **OBJEKTIVAT:**


- Të gjejë se si funksionon një grup si një grup i vetëm, kur kryen një detyrë të vështirë.
- Të ilustrujë se si njerëzit mund të marrin role të ndryshme në grup.

 **MJETET:** Një litar, që lidhet në mënyrë të tillë, që të formojë një rreth të gjatë sa gjysma e grupit; mund të mbahet në të duke e kapur me të dyja duart.

 **KOHA:** 20 – 30 minuta, në varësi të gjatësisë së kohës që ti bën analizën.

 **ECURIA:**

1. Ndaje grupin në dy grupe: vëzhguesit e heshtur dhe formuesit e katrorit.
2. Shtrije litarin në formë rrethi mbi dysheme në mes të dhomës.
3. Thuaji grupit që formoi katrorin të qëndrojë në formë rrethi përreth litarit. Vëzhguesit duhet të zbrapsen dhe të vështrojnë në heshtje.
4. Thuaji grupit që formoi katrorin të ngrerë litarin me të dyja duart.
5. Thuaji grupit që formoi katrorin të mbyllë sytë dhe të ecë në formë rrethi dy herë, me qëllim që njerëzit të çorientohen disi.
6. Pastaj thuaji grupit të formojë një katror të saktë me anë të litarit (duke mos parë).
7. Grupi tjetër duhet të vëzhgojë dinamikën e asaj që ndodh, pa komentuar.
8. Ndrysho rolet e grupeve dhe pastaj bëj analizën.

 **KOMENTET:** Ky është një ushtrim tejet i fuqishëm, që zbulon shumë rreth tipave të aktorëve brenda grupit, duke përfshirë edhe drejtuesit, sabotatorët etj. (shih Kapitullin 3). Gjithmonë dalin shumë liderë. Përdore diskutimin për të nxjerrë këto çështje:

- *Cili u ndje i shqetësuar?*
- *A ishin të qarta udhëzimet e dhëna nga anëtarët e grupit?*
- *Si iu përgjigje urdhërave ose kërkesave kontradiktore?*
- *Kush mori drejtimin në dorë? Përse? Kur?*
- *Kush luajti rolin e ndërmjetësit?*
- *Kush ndejti i qetë?*
- *Kush i kontrolloi dhe vlerësoi urdhërat nga të tjerët?*

Qëllimi nuk është që vlerësimi të marrë karakter personal, por për të nxjerrë një sërë cilësish të anëtarëve të një grupi dhe se sa të suksesshëm apo të pasuksesshëm janë ata kur ndërveprojnë me njëri - tjetrin për të kryer detyrën. Një version tjetër është që pjesëmarrësve t'u thuhet që nuk duhet të flasin. Kjo e bën ushtrimin edhe më të vështirë.

37. QOSHJA IME

✓ **OBJEKTIVAT:** ■ Të nxjerrë në pah që objektivat dhe qëllimet e grupit dhe ato individuale mund të kombinohen

👁️ **MJETET:** Nuk nevojiten.


🕒 **KOHA:** 5 minuta.

✍️ **ECURIA:**

1. Thuaji grupit të formojë një rreth, duke kapur duart me njëri - tjetrin.
2. Kërko që secili të zgjedhë një qoshe të dhomës që “u përket atyre”, por të mos ia tregojnë askujt.
3. Shpjego se objektivi i ushtrimit është të sigurojë që ju “vizitoni qoshen tuaj”. Rrethi nuk duhet të priset gjatë këtij procesi.
4. Diskutim dhe analizë.


“ **KOMENTET:** Ajo që ndodh shpesh në këtë ushtrim është që individët këmbëngulin që të nxisin secilin të shkojë në qoshen e tij dhe vetëm në qoshen e tij. Sikurse mendojnë shumica e pjesëmarrësve, ata duhet të vizitojnë dhe të qendrojnë në qoshen e tyre. Grupet rallë vendosin bashkarisht që edhe të shkojnë në qoshen e të tjerëve, duke realizuar në këtë mënyrë objektivin e secilit individ nëpërmjet bashkëpunimit në grup.

38. ROLET NË GRUP

 **OBJEKTIVAT:** ■ Të nxisë diskutimin në grup lidhur me faktin se si ndikohet dinamika në grup nga karakteristikat e anëtarëve të secilit grup.

 **MJETET:** Kartona në vegjël dhe një letër transparente e përgatitur ose tabak letre.

 **KOHA:** 20 minuta.

 **ECURIA:** 1. Ndaji njerëzit në grupe. Ky ushtrim funksionon më mirë në grupe të vogla, veçanërisht me ata që do të angazhohen në një veprimtari së bashku (p.sh., grupet para punës në terren).

2. Paraqit një fletë transparente ose tabak letre në me 5 (ose me më shumë, ose me më pak) “tipe të ndryshme” të identifikuar nga shkronjat (A – E) ose numrat (1 – 5).

Në fletën transparente ose në tabakun e letrës duhet të shkruhen këto fjali:

- A. Unë dua të udhëheq një grup që nga fillimi.
- B. Unë dua të pres që dikush tjetër të marrë drejtimin: vetëm kur di pozicionin e të tjerëve mundohem që të ndikoj në ngjarjet.
- C. Nuk dua të kontribuoj direkt në diskutimet në grup, por preferoj t'i bëj gjërat me qetësi, duke krijuar aleanca me të tjerët.
- D. Unë jam tolerant dhe lë të tjerët që të veprojnë. Ndërhyj vetëm atëherë kur gjërat bien ndesh me dëshirat e mia.
- E. Preferoj të mos marr në dorë drejtimin, por të kryej detyrat praktike që vendos grupi.

3. Kërko që secili të zgjedhë atë karakteristikë që paraqet sjelljen e tij në grupe pjesën më të madhë të kohës (sigurisht, kushte të ndryshme kërkojnë përgjigje të ndryshme, kështu që thekso se kjo lidhet me shumicën e sjelljes më të zakonshme).

4. Kërko që secili të shkruajë në një karton të vogël shkronjën që paraqet më mirë sjelljen e tij më të zakonshme. Mos ua trego këtë të tjerëve.

(vazhdon në faqen tjetër)

38. ROLET NË GRUP



ECURIA:


5. Grumbulloji të gjithë kartonat, duke ruajtur anonimatin. Përzjeji dhe vendosi në dysheme me anën e shkruar nga dyshemeja. Thuaji grupit që t'i kthejë në anën ku është shkruar dhe diskuto rreth përbërjes së grupit lidhur me ekuilibrin e roleve dhe informacionit të sjellë. Diskutimi duhet të mbetet anonim (vetëm në qoftë se dikush kërkon të flasë në mënyrë të veçantë për veten).



KOMENTET:


Diskutimi rreth përbërjes së grupit mund të ndihmojë shumë për të inkurajuar një grup që të krijojë një mori perceptimesh individuale për rolet në grup, në një numër relativisht të vogël njerëzish. Secili është i ndryshëm, dhe grupet funksionojnë më mirë kur bashkohen aftësitë e ndryshme në grup. Të kuptuarit e kësaj çështjeje mund të ndihmojë për të parandaluar konfliktet e dëmshme që mund të krijohen në punën me grupe më vonë. Meqë tani pjesëmarrësit presin tipa të caktuar sjelljesh, ata mund të vlerësojnë më shumë këndvështrimet e të tjerëve për punën në grup.


39. PËRJASHTIMI I NUMRAVE

-  **OBJEKTIVAT:**
- Të identifikojë rolet e ndryshme që luhen nga individë të ndryshëm në grup.
 - Të zbulojë çështjet që lidhen me pavendosmërinë në grup dhe përjashtimin midis grupit të madh.

 **MJETET:** Nuk nevojiten.

 **KOHA:** 20 minuta.

-  **ECURIA:** Ky është një variant i “Lojës me numrat” (Nr. 15).
1. Trajnuesi cakton një person që e thërret dhe asnjë tjetër nuk lejohet të flasë.
 2. Pastaj thirrësi thotë me zë të lartë kombinimet e numrave, si, p.sh.: dyshat, treshat, pesat. Kjo mund të japë numrin e saktë të grupeve të krijuara sipas numrit të dëshiruar ose mund të çojë në përjashtimin e disa individëve.
 3. Individët që mbeten ose mund të mos marrin pjesë në ushtrim dhe të ulen, ose të bashkohen me grupin duke rritur numrin e tij.
 4. Thirrësi vazhdon të thotë me zë të lartë grupet me numrin e dëshiruar, derisa i njëjti person të ikë ose dikush tjetër vendos që të lëvizë ose të ikë.
 5. Ushtrimi vazhdon derisa ngelen vetëm dy persona.

 **KOMENTET:** Pjesëmarrësit pyeten që të zbulojnë se si u ndjenë kur u përjashtuan nga ushtrimi.

- *A u ulët menjëherë?*
- *Sa e vështirë ishte që të bashkoheshe me grupin që ishte tashmë i formuar dhe ta ndërprisje atë?*

Pjesëmarrësit pyeten se si u ndjenë ata në grupet e qëndrueshme.

- *Si u ndjetë kur dikush u përpoq të bashkohej me ju?*

Ky ushtrim është i dobishëm për trajnuesit në identifikimin e roleve të luajtura nga individët në grup: Cilët janë viktimat? Cili është ai që nuk dorëzohet? Një variant i këtij ushtrimi është që trajnuesi të bashkohet me grupin, të rrijë pa folur gjatë gjithë kohës dhe të mos ulet asnjëherë.



40. SHKREPËSET

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të bëjë që secili të vlerësojë kontributin e vet.
 - Të nxisë pjesëmarrësit që të dëgjojnë të tjerët gjatë diskutimit.


👁️ **MJETET:** 3 deri 6 shenja (p.sh., shkrepëse ose monedha) për secilin pjesëmarrës.

🕒 **KOHA:** Ndryshon, por duhet të specifikohet që në fillim.

- 📖 **ECURIA:**
1. Secilit person i jepet numri i njëjtë i shenjave, numri total i të cilave varet nga koha në dispozicion.
 2. Sa herë që një person i flet grupit, ai vë një nga këto shenja në qendër.
 3. Nëse nuk kanë më shenja, ata nuk mund të flasin.

“ **KOMENTET:** Meqë çdo vërejtje zakonisht është me vlerë – ndoshta një e treta e kontributit total që japin folësit – ata, së pari, duhet të vlerësojnë kontributin e tyre dhe të marrin parasysh nëse ka vlera kontributi i tyre lidhur me vlerën që ka vetë ky kontribut dhe a përputhet ai me qëllimin e ushtrimit. Duke ditur se çdo folës e ka bërë atë vlerësim, të tjerët mund të jenë më të prirur të dëgjojnë, megjithëse ekziston rreziku që të tjerët do të jenë të zënë për të vendosur nëse do të flasin apo do të dëgjojnë.

Një mënyrë tjetër është që në vend të vendosjes së shkrepëseve në qendër, secili folës t'i japë shkrepësen personit me të cilin flet.



41. LOJA E JASTËKUT

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Ta bëjë diskutimin më të organizuar dhe të nxisë të mësuarit.
 - Të zbulojë rolet e luajtura nga njerëzit në diskutim.

👁️ **MJETET:** Një objekt i butë që mund të pasohet ose të hidhet aty rrotull, si, p.sh. jastëk, një pulovër e mbledhur ose një top i përbërë nga letra të mbledhura shuk.

🕒 **KOHA:** Aq kohë sa duket për një diskutim.

- ✍️ **ECURIA:**
1. Gjatë diskutimit grupi është i ulur ose rri në këmbë në formë rrethi. Thuaju pjesëmarrësve që mund të flasin vetëm në qoftë se mbajnë jastëkun, ndryshe nuk duhet të flasin dhe duhet të dëgjojnë atë çfarë thuhet.
 2. Kur dikush ka mbaruar së foluri, ai ia kalon jastëkun ose dikujt që e ka kokën të ngritur, i cili ka dëshirë të flasë, ose dikujt tjetër.
 3. Pjesëmarrësit mund të vendosin jastëkun në qendër të rrethit në dysheme, ku mund ta marrin të tjerët në grup. Kjo mund t'i përjashtojë ata që janë të ngritur. Nëse dikush merr jastëkun dhe nuk dëshiron të flasë, ai thjesht mund ta pasojë atë më tej.

💬 **KOMENTET:** Pas ushtrimit, diskuto se si ndjehesh kur mban objektin, kur e merr atë pa e kërkuar dhe ta marrësh kur e kërkon vetë. Atyre që iu dha jastëku pa pyetur, mund të jenë ndjerë në siklet dhe mund të jenë ndjerë të detyruar për të marrë pjesë.

Loja i nxit pjesëmarrësit të dëgjojnë. Ajo u krijon mundësi anëtarëve që janë të heshtur të flasin. Gjithashtu, i bën të vetëdijshëm anëtarët që dominojnë grupin për masën e të folurit, pasi mbajnë jastëkun. Sapo kjo ecuri mësohet dhe bëhet automatike, shumë grupeve iu duket një mënyrë e dobishme për të organizuar diskutimin në grup. Ajo përjashton nevojën për të pasur një kryetar autoritar, pasi vendosen rregulla. Ajo shpesh ndihmon në sesionet e tjera plenare, kur pjesëmarrësit do t'i referohen përsëri lojës me jastëk, për t'u siguruar që secili ka mundësi të flasë.



Një mënyrë tjetër e kësaj loje është që pjesëmarrësit t'i kthejnë kurrizin folësit, në qoftë se mërzi të me të, ose të gjejnë se cilat nga ato që thuhet nuk janë me vend. Ky është një veprim shumë i drejtpërdrejtë, i cili shërben për të stimuluar diskutimin gjatë sesionit, në të cilin bëhen vërejtje.

✓ **OBJEKTIVAT:** ■ Të aftësohen pjesëmarrësit që të vëzhgojnë më me efektivitet sjelljet pa fjalë.

👁️ **MJETET:** Nuk nevojiten.


🕒 **KOHA:** 20 minuta.


- ✍️ **ECURIA:**
1. Pjesëmarrësve iu kërkohet të formojnë çifte që punojnë bashkë.
 2. Të gjithë ata që janë germa **A** mund të marrin cilindo pozicion që dëshirojnë. Germa **B** e vëzhgon atë dhe përpiqet ta mbajë mend - pozicioni i trupit, pozicioni i gjymtyrëve, pozicioni i duarve dhe këmbëve, pjerrësia e kokës. Pastaj germa **B** rrotullohet.
 3. Germa **A** ndryshon një element në pozicionin e tij/saj. Germa **B** rrotullohet përsëri dhe përpiqet të gjejë se çfarë ka ndryshuar.
 4. Germa **A** dhe germa **B** ndërrojnë rolet.
 5. Përsërite disa herë.
 6. Trajnuesi duhet të theksojë se, fillimisht, germa A dhe germa B duhet të bëjnë ndryshime të cilat janë të lehta për t'u dalluar, por që më pas këto ndryshime duhet të jenë më të holla dhe më të vështira për t'u dalluar.

💬 **KOMENTET:** Diskutimi në grup të madh mund të fokusohet mbi pyetje të tilla, si:


- *Çfarë është e lehtë dhe çfarë është e vështirë për t'u dalluar dhe përse?*
- *Çfarë duhet që të jesh një vëzhgues i mirë?*


Shumica e njerëzve i kushtojnë më shumë vëmendje këmbëve dhe shprehjeve të fytyrës. Nuk vënë re fare pozicionin e trupit dhe përpiqen të mos vënë re nëse një person ulet drejt apo i kërrusur. Megjithatë, pozicioni është shumë i rëndësishëm për të gjykuar qëndrimet dhe ndjenjat e dikujt tjetër.

 **OBJEKTIVAT:** ■ Të sensibilizojë pjesëmarrësit që sjellja jогоjore mund të tregojë dominimin, nënshtrimin dhe miqësinë.

 **MJETET:** Nuk nevojiten mjete, por pjesëmarrësit mund të përdorin karrike, shkopa etj. për improvizime.

 **KOHA:** 15 – 20 minuta.

-  **ECURIA:**
1. Kërko që grupi të ndahet në grupe më të vogla me 5 ose 10 persona, të cilët të qëndrojnë me fytyrë nga brenda, në formë rrethi.
 2. Konkursi i parë është që secili grup të tregojë dhe të kryejë sa më shumë veprime, pa fjalë, që tregojnë dominim. Një person kryen veprimin dhe pastaj i gjithë grupi duhet ta përsërisë atë, me qëllim që të numërojë pikët.
 3. Vazhdo derisa një ose dy grupe të mos kenë më ide.
 4. Me shpejtësi pyet për pikët dhe fto secilin grup të për zgjedhë mënyrën më të mirë pa fjalë.
 5. Nga ana tjetër, grupet qëndrojnë dhe u tregojnë të tjerëve anën më të mirë.
 6. Përsërite për të treguar nënshtrim.
 7. Përsërite kur tregohesh i/e mirë me njerëzit.

 **KOMENTET:** Ky ushtrim është shumë i efektshëm kur kombinohet me diskutimin mbi rëndësinë e sjelljeve pa fjalë. Një ushtrim për të gjallëruar pjesëmarrësit apo një ushtrim grupformues, p.sh., “Sallata e frutave”, mund të ndihmojë si një mënyrë për të çuar te ky ushtrim. Një përmbledhje e diskutimit mund të nxjerrë se çfarë është vënë re për tipat e pozicioneve të trupit dhe gjesteve. Ky ushtrim zakonisht nuk tregon se sa të rëndësishëm janë sytë për të treguar se si ndjehet një person dhe se çfarë mendon ai, gjë që mund të tregohet duke mbajtur zyze të errëta.

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të ilustrojë se si një mori faktorësh influencojnë mbi vendimin për të rënë dakord apo për të qenë kundër me një pikë të caktuar të argumentit.
 - Të demonstrojë se sa e lehtë është për të debatuar një çështje me shumë njerëz që ju mbështesin fizikisht.

👁️ **MJETET:** Dy karrike.

🕒 **KOHA:** 10 minuta.

- 📖 **ECURIA:**
1. Kërko që dy pjesëmarrës të dalin vullnetarë për të bërë një debat publik lidhur me një çështje të paravendosur. (Kjo mund të lidhet me një diskutim teorik të mëparshëm, si, p.sh., *Pra, është gjithmonë një proces pozitiv.*) Ju mund t'u kërkonit atyre të zgjedhin një temë që është me rëndësi për të dy. Mund t'ju nevojitet të kërkonit që njëri të luajë rolin e mbrojtësit të djallit.
 2. Uli të dy në dy karrike përballë njëra - tjetrës.
 3. Pjesëmarrësve të tjerë u kërkohet të qëndrojnë anash, në një “zonë neutrale”, në nivelin e hapësirës midis dy karrikeve. Ndërkohë që zhvillohet debati, ata duhet të ecin dhe të qëndrojnë mbrapa personit i cili ka bërë një pohim, me të cilin ata janë dakort. Në qoftë se gjatë zhvillimit të diskutimit/debatit ndërrojnë mendje ose nuk janë dakord me diçka të thënë, atëherë ata duhet të ecin për të qëndruar mbrapa debatuesit tjetër.

“ **KOMENTET:** Ky ushtrim tregon fuqishëm uljet dhe ngritjet në çdo diskutim. Ai është veçanërisht i efektshëm, në qoftë se diskutimet për një çështje të caktuar, për të cilën grupi nuk ka qenë i një mendjeje gjatë sesioneve të kaluara, kanë mbetur në vend. Kjo çështje, pastaj, mund të merret si pikë për debat. Ndërkohë që zhvillohet debati në kushte të kontrolluara, emocionet kanë tendencë që të jenë më pak të zjarrta dhe argumentat më të qartë. Diskutimi i problemeve në këtë mënyrë i pakëson tensionet.

Për detyrën e analizës bëju debatuesve pyetje të ndryshme:

- Si u ndjetë kur të gjithë të tjerët qëndronin pas jush?
- Si u ndjetë kur të gjithë qëndronin pas debatuesit tjetër?

(vazhdon në faqen tjetër)

44. DEBATI I VOTIMIT (vazhdim)

“ KOMENTET:

Pyet pjesëmarrësit e tjerë:

- *Çfarë të bëri që të lëvizje? Ishte për shkak të cilësisë së debatit apo gabimet kryesore që u bënë nga një person?*
- *Çfarë roli luajti gjuha e gjesteve në vendimin tënd për të lëvizur?*

Një mënyrë tjetër është që t'i lejojmë pjesëmarrësit e tjerë të zëvendësojnë një debatues që është ulur, në qoftë se dëshirojnë të hedhin ide të reja. Kjo e bën përvojën më pak konfrontuese për debatuesit dhe mirëpret ngadalë edhe pikëpamjet e tjera.

Një mënyrë që quhet “Han-ji”, “Na-ji” (që në gjuhën sanskrite do të thotë “Po, zotni” dhe “Jo, zotni”) është ku debatuesit, në mënyrë aktive, përpiqen të gjejnë aleatë në grup, duke u bërë atyre pyetje apo shaka etj. me spec, apo që ngjallin polemika.

- ✓ **OBJEKTIVAT:** ■ Të demonstrojë se është e lehtë që edhe udhëzimet më të thjeshta mund të keqinterpretohen, ngaqë varet se si merr ato, veçanërisht në qoftë se përdoren fjalë të paqarta ose personi që i merr këto udhëzime nuk (ose nuk mund) kërkon sqarime.

👁️ **MJETET:** Disa fletë letre (fletët në formë katrori janë më interesante, pasi një pjesëmarrës i mprehtë mund të parapëlqente ta paloste atë nga cepi në cep, duke krijuar kështu një trekëndësh.

🕒 **KOHA:** 5 – 10 minuta.



- 📖 **ECURIA:**
1. Zgjidh 4 pjesëmarrës (ose kërkonti që të dalin vullnetarë 4 persona) dhe kërkojui të rrinë në këmbë në krye të sallës, përballë pjesës tjetër të grupit.
 2. Jepi secilit një fletë letre dhe tregoju këto dy rregulla: 1. Secili gjatë ushtrimit duhet të mbyllë sytë; 2. nuk duhet të bëjnë pyetje.
 3. Udhëzoji që të palosin fletët përgjysmë dhe pastaj ta grisin cepin e djathtë të fletës. Thuaju të palosin përsëri letrën përgjysmë dhe pastaj të grisin cepin e sipërm të saj. Thuaju që ta palosin letrën përgjysmë përsëri dhe pastaj të grisin cepin në të majtë të letrës.
 4. Pastaj udhëzoji që të hapin sytë e t'ia tregojnë letrën e shpalosur njëri - tjetrit dhe të tjerëve.

💬 **KOMENTET:** Ka shumë të ngjarë që ato të mos jenë të gjitha njëloj. Për të filluar analizën, përdor pyetjet e mëposhtme:


- Çfarë fjalësh të përdorura në udhëzimet që jepen mund të keqinterpretohen në mënyra të ndryshme?
- Si mund të ishin udhëzimet më të qarta për ta pakësuar shkallën e paqartësisë?
- Si mund t'i inkurajojmë njerëzit të pyesin për t'u qartësuar, kur ata nuk kuptojnë diçka?

- ✓ **OBJEKTIVAT:**
- Të tregojë se sa e vështirë është që të transmetosh informacionin vetëm me fjalë.
 - Të krahasojë lehtësinë në komunikimin e njëanshëm dhe të dyanshëm.

👁️ **MJETET:** Dy fije letër si në figurën djathtas.

🕒 **KOHA:** 10 –15 minuta.

- ✍️ **ECURIA:**
1. Kërko që njëri të dalë vullnetar. Ule atë person me kurriz me pjesën tjetër të grupit.
 2. Jepi vullnetarit fletën me figurën në të dhe sigurohu që nuk mund ta shohë askush nga grupi.
 3. Pastaj vullnetarit i kërkohet t'i shpjegojë me gojë grupit se çfarë shikon ai/ajo, duke dhënë vetëm udhëzime me fjalë lidhur me mënyrën se si mund ta vizatojë figurën. Pjesës tjetër të grupit i kërkohet që të vizatojnë atë çfarë ju thuhet nga vullnetari. Vullnetarit nuk i lejohej që të bëjë gjeste, të kthehet majtas – djathtas etj.
 4. Në fazën e parë të lojës, pjesës tjetër të grupit nuk i lejohej të bëjë pyetje; ata duhet ta vizatojnë figurën në heshtje. Kur vullnetari ka mbaruar udhëzimet, jepi atij/asaj fletën e dytë. Është e njëjta figurë, por të tjerët nuk do ta dinë këtë.
 5. Grupit i kërkohet që të fillojë një fletë tjetër dhe ushtrimi përsëritet, por këtë herë grupi mund të pyesë dhe vullnetari lejohej të përgjigjet me fjalë (vullnetarit nuk i lejohej që të përdorë duart etj.). Në fund, krahasohen figurat e bëra me origjinalin.



(vazhdon në faqen tjetër)

46. VIZATIMI I TULLAVE (vazhdim)

66 KOMENTET:

Në qoftë se koha është e shkurtër, ky ushtrim mund të ndalet pas fazës së pare, për të treguar vështirësitë që paraqet komunikimi i njëanshëm. Analiza duhet të përqendrohet në diskutimin e lehtësisë relative të komunikimit të njëanshëm dhe të dyanshëm, si dhe vështirësive kur ajo është vetëm me fjalë, krahasuar me kombinimin e komunikimit me fjalë dhe pa fjalë. Mund të diskutohen pyetjet e mëposhtme:


- *Në cilën pikë u ngatërrua grupi?*
- *Çfarë hamendjesh kishte grupi?*
- *Çfarë do ta kishte bërë më të lehtë për grupin që të kuptonte (analogjitë, si tullat, drejtimet gjeografike)?*

Kjo diagramë është e mirë sepse në qoftë se përshkruhet qartë, mund të vizatohet qartë. Në qoftë se përdoren diagrama të tjera, ato nuk duhet të jenë të vështira. Ato duhet të jenë shumë të strukturuar dhe vullnetarët duhet të kenë mundësi që të bëjnë analogji me objektin.

 **OBJEKTIVAT:** ■ Të zhvillojë aftësitë e të dëgjuarit aktiv dhe empatik.

 **MJETET:** Artikuj gazetash ose revistash sipas nevojës.

 **KOHA:** 30 – 40 minuta.

 **ECURIA:**

1. Zgjidh një temë të diskutueshme nga revistat ose gazetatat vendore (nga fusha e politikës, punës, menaxhimit ose ndonjë temë tjetër që mund të pëlqehet).
2. Ndaji pjesëmarrësit në grupe me nga 3 persona. Secili grup zgjedh “folësin”, “dëgjuesin” dhe “referuesin”. Tema e zgjedhur diskutohet nga folësi i cili, pa ndërprerje, shpjegon ndjenjat e tij për këtë temë. Pasi folësi ka mbaruar, dëgjuesi përmbledh (pa parë shënimet) çfarë u tha për atë temë. Pasi ka përfunduar kjo, folësi dhe referuesi mund të korrigjojnë ose amplifikojnë çfarëdolloj çështjeje të pohuar nga dëgjuesi. Referuesi është i vetmi person që lejohet të përdorë shënimet.
3. Pas 8 – 10 minutash diskutim, zgjidh një temë të re dhe ndërro rolet, duke përdorur të njëjtën mënyrë. Pas 6 – 10 minutash, përdor një temë tjetër dhe role të reja, duke mundësuar në këtë mënyrë që secili person të luajë njërin nga rolet.

 **KOMENTET:** Përdor pyetjet e mëposhtme për të bërë analizën:


- *Në rolin tënd si folës, a hase ndonjë vështirësi ose pate ndonjë çast të pavolitshëm?*
- *Po në rolin e dëgjuesit apo të referuesit?*
- *A konstatove ndonjë pengesë që pengonte të dëgjuarit efektiv?*
- *Në rolin tënd si dëgjues, përse ishte e vështirë për të përmbledhur dhe perifrazuar komentet e folësit?*
- *Çfarë dobie kanë shënimet?*
- *Si lidhet ky ushtrim me mbledhjen e të dhënave dhe intervistimin në terren?*

Një mënyrë tjetër është që të diskutohet një temë personale, duke i thënë dëgjuesit të mos japë shenja që miratojnë apo kundërshtojnë, duke u ngrysur apo miratuar me kokë. Në këtë mënyrë, vihet theksi në atë që të tregohet vlera e qëndrimit ndaj dëgjimit joparagjykses dhe se tundja e vazhdueshme e kokës nga dëgjuesi nuk është gjithmonë e këndshme. Gjatë analizës, pyeti pjesëmarrësit se si u ndjenë kur gjestet e tyre u kufizuan. Zakonisht, ata do të thonë që iu duk e vështirë. Kur pyeten folësit lidhur me mendimin e tyre për dëgjuesin jo të vëmendshëm, zakonisht thonë që nuk kishte problem.

 **OBJEKTIVAT:** ■ Të ilustrojë se si gjestet papërshtatshme ndikojnë në komunikimin gojor.

 **MJETET:** Nuk nevojiten.

 **KOHA:** 5 minuta.

 **ECURIA:**

1. Ndaji pjesëmarrësit në çifte, duke iu kërkuar të bashkohen me dikë, me të cilin nuk kanë punuar ende.
2. Një person nga secili çift është “kundërshtuesi” (d.m.th. vetëm tund kokën majtas - djathtas), personi tjetër është “miratuesi” (d.m.th. vetëm tund kokën poshtë e lart).
3. Kërkoju çifteve të bëjnë një bisedë të shkurtër. Pas një minute, kërko që partnerët në secilin çift të ndërrojnë vendet, kundërshtuesit të bëhen miratues dhe anasjelltas.
4. Vërejtjet konstruktive mund të bëhen në çifte ose në seancën plenare.


 **KOMENTET:** Për analizën përdor pyetjet e mëposhtme:

- A e ndjeve që po të dëgjonin?
- A të ndërpritej mendimi kur tundje kokën kur miratoje ose kundërshtojë?
- A mund të raportosh lidhur me sa u tha?
- Si ndikonin gjestet tuaja joharmonike në komunikimin me fjalë?

✓ **OBJEKTIVAT:** ■ Të tregojë se si e humbet informacioni përmbajtjen kur transmetohet nëpër “kanale” të ndryshme.

👁️ **MJETET:** Një shkrim i shkurtër gazete apo ndonjë ndodhi e shkruar.

🕒 **KOHA:** 10 – 12 minuta



- ✍️ **ECURIA:**
1. Zgjidh ndonjë shkrim të kohëve të fundit nga ndonjë gazetë, por që të mos jetë aktualisht nëpër lajme.
 2. Ndaje grupin në grupe më të vogla prej 4 – 5 pjesëmarrësish. U thuaj që t'i venë vetes një numër, por sipas rradhës.
 3. Kërkoju numrave 1 që të qëndrojnë në dhomë, ndërsa të tjerëve që të largohen. U thuaj numrave 1 se do t'i lexosh një ndodhi; ata nuk duhet të mbajnë shënime, por vetëm të dëgjojnë.
 4. Pasi e keni lexuar ndodhinë (pa u lejuar që t'u bëjnë pyetje), kërko që numrat 2 të vijnë në dhomë, dhë që numrat 1 t'ia tragojnë ndodhinë atyre. Pastaj fton numrat 3 të vijnë dhe të dëgjojnë ndodhinë prej 2-shave, ndërkohë që 1-shat vetëm vëzhgojnë. Vazhdoni derisa të përfshini të gjithë pjesëmarrësit në lojë.
 5. Pyesni ndonjërin prej numrave 5, që ta përsërisin ndodhinë që kanë dëgjuar.
 6. Fillo analizën duke e lexuar edhe njëherë ndodhinë origjinale, por këtë herë me të gjithë pjesëmarrësit në dhomë.

(vazhdon në faqen tjetër)

49. TELEFONI I PRISHUR DHE COPËZA TË NGJARJES (vazhdim)

66 KOMENTET: Shpesh ky ushtrim shkakton habi kur grupi dëgjon se si përfundon ndodhia origjinale:

- *Nga ndodhia origjinale, sa informacion humbi në secilin prej tregimeve të transmetuara? Cfare u shtua në secilin prej varianteve?*
- *Cfarë gabimesh apo ndryshimesh u vunë re në kalimet nga një grup tek tjetri?*
- *Si mund ta kishim përmirësuar transmetimin e fakteve si dhe të vetë ndodhisë? Si e përftojmë ne informacionin në lidhje me ndodhitë e vërteta?*

Më poshte prezantohet edhe një version më i shkurtër i lojës telefoni prishur (që njihet edhe si pëshpërma kineze). Të gjithë pjesëmarrësit rrijnë në një rresht ose në rreth. Pëshpëriti personit në të majtë një apo dy fjali. Ai/ ajo duhet t'ia pëshpërisë ekzaktësisht të njëjtat fjali personit në të majtën e vet. Në këtë mënyrë, fjalitë transmetohen përgjatë rrethit, derisa personi i fundit e thotë me zë atë që ka dëgjuar. Pyetjet 2 dhe 3 më sipër mund të përdoren edhe në këtë rast për të bërë analizën.


Lehtësuesi mund të shpjegojë se qëllimi i kësaj loje është të ilustrojë se si mund të ngatërrohen dhe shndërrohen mesazhet gjatë transmetimit nëpër hallka apo nga goja në gojë, si p.sh: nga zyra qendrore në atë të linjës, e më pas tek personi apo punonjësi përgjegjës, e prej tij tek njerëzit në terren, dhe anasjelltas. Është shumë më mirë që informacioni të kërkohet drejtpërdrejt në burimin e vet, pasi atje edhe mund të shkëmbehen mendimet apo idetë.

✓ **OBJEKTIVAT:** ■ Të tregojë se si ndikojnë ndodhitë e kohëve të fundit, në mënyrën se si ne e shohim botën.

👁️ **MJETET:** Fletë të mëdha letre ose shkumës.


🕒 **KOHA:** 5 minuta.

✍️ **ECURIA:** 1. Trego këtë diagramë të vizatuar në një fletë letre ose tabelë. ▶



2. Pyesni grupin: “Cfarë shihni?” Gjasat janë që ju të merrni përgjigje si “shigjeta”, “tre shtëpi të përmbysura”, “drejtim majtas”.

3. Kur të merrni përgjigjen “dy K”, nënvizoni mirë të dy K-të dhe vazhdoni duke treguar diagramën tjetër. ▶



4. Pyesni pjesëmarrësit: “Po tani çfarë shihni?” Ka shumë të ngjarë që ata menjëherë të përgjigjen “dy H”. Tani pyesni pjesëmarrësit nëse ata do i kishin parë dy H-të nëse dikush nuk do u kishte treguar më parë dy K-të?

🗨️ **KOMENTET:** Është mirë që diagramat t’i përgatisni që më parë, pasi nëse këtë e bëni në sy të pjesëmarrësve, ka gjasa që ata t’i shohin K-të dhe H-të.

Bëni pyetjet e mëposhtme:

- Pse i vutë re H-të më me lehtësi se K-të? (sepse ju u ndikuat nga ajo që sapo kishte ndodhur: syri sheh, por mendja vlerëson).
- Në punën apo bashkëveprimin tuaj me të tjerët, në ç’mënyrë syri juaj sheh dicka dhe mendja juaj dicka tjetër?

Në punën apo jetën tuaj të përditshme, a keni patur raste që ndodhitë e kohëve të fundit të kenë ndikuar në mënyrën se si ju keni kuptuar apo reaguar?

